

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME POSTDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

**“ROLI I POLICISË NË PARANDALIMIN E KRIMINALITETIT
NË KOMUNËN E TETOVËS”**

KANDIDAT:
Liridona Emini

MENTOR:
Prof. Dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2019

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Qëllimi	5
Metodologjia e hulumtimit	6

Kapitulli I

1. PËRKUFIZIMI, ZHVILLIMI HISTORIK, ETIKA, KONTROLLI, TRANSPARENCA E POLICISË, DHE FAKTORËT E KRIMINALITETIT	7
1.1. Nocioni i policisë	7
1.2. Zhvillimi historik i policisë në botë dhe në Republikën e Maqedonisë	8
1.3. Etika në polici	15
1.4. Kontrolli i policisë dhe transparenca	19
1.5. Faktorët e kriminalitetit	22
1.5.1. Faktorët e jashtëm (objektivë) të kriminalitetit	23
1.5.2. Faktorët e brendëshëm (subjektivë).....	26

Kapitulli II

2. Parimet themelore të punës së policisë	29
2.1. Parimi i ligjshmërisë në punën e policisë.....	30
2.2. Parimi i objektivitetit në punën e policisë.....	31
2.3. Parimi i efikasitetit në punën e policisë.....	32
2.4. Parimi i proporcionalitetit në punën e policisë	32
2.5. Parimi i humanitetit në punën e policisë.....	33
2.6. Parimi i shpejtësisë dhe i befasisë në punën e policisë.....	34
2.7 Parimi i kordinimit dhe i bashkëpunimit në punën e policisë	34

Kapitulli III

3. VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË, JETËS DHE TRUPIT, QARKULLIMIT PAGESORË DHE EKONOMISË.....	36
3.1. Larja e parave në Republikën e Maqedonisë nga viti 2013-2018.....	36
3.2. Trafikimi i substancave narkotike ne Komunën e Tetovës.....	40

3.3. Vjedhjet dhe llojet e vjedhjeve në rethin e Komunës së Tetovës.....	44
3.4. Viktimat e vrasjeve në Komunën e Tetovës	50
3.5. Trafikimi me njerëz në Republikën e Maqedonisë	54

Kapitulli IV

4. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT.....	59
4.1. Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit në Komunën e Tetovës	59
4.2. Roli i Prokurorisë në parandalimin e kriminalitetit në Komunën e Tetovës...	62
4.3. Roli i Gjykatës Themelore të Tetovës në parandalimin e kriminalitetit	64
Përfundimi	67
Literatura	69
Burime interneti	71

Hyrje

Influencat aktuale të ditëve të sotme lidhur me krizat sociale, ekonomike, shoqërore si dhe bashkë me dinamikën e lëvizjes së kriminalitetit nëpër periudha të ndryshme kohore, kanë sjellë vështirësi mjaftë të mëdha shoqërore dhe individuale në mbarë botën duke ngjallur ndjenjën e frikës dhe të pasigurisë tek komuniteti dhe njëkohësishtë duke nxitur rivalitetin e luftës për egzistencë.

Kriminaliteti si dukuri masive dhe si reaksion i individit dhe shoqërisë paraqet epidemi sociale të shfrenuar që godetë njerëzimin në të gjitha sferat e civilizimit. Ky fenomen është një fushë e gjërë kontraverse i cili manifestohet nga individë, forma dhe sjellje devijante të ndryshme jo ligjore të cilat paraqesin probleme serioze të kushtueshme dhe shkaktojnë dëme të pariparueshme gjithpërfshirëse duke mos përjashtuar edhe vendin tonë.

Duke iu referuar situatës atipike në shoqërinë tonë rezulton se në këtë fenomen evidentohet përfshirje masive ku shihet qartë se krimi dukshëm ka agravuar në përmasa seriozishtë shqetësuese dhe të rrezikshme ku ne sot aksidentalishtë dhe padrejtësishtë jetojmë një situatë të zgjeruar të krimit në shoqëri.

Edhe pse kriminaliteti kohët e fundit është rritur ndjeshëm vëllimi, struktura, dinamika dhe shkaqet e tij nuk mund të definohen tërësishtë dhe në mënyrë precize, mirëpo luftimi dhe parandalimi i kësaj dukurie serviliste është detyrë e të gjithëve e cila kërkon angazhim, përfshirje dhe bashkëpunim, parimishtë nga subjektet (institucionet) e ndryshme shtetërore që janë të ngarkuar me ligj dhe së dyti kërkon përgjegjësi shoqërore-qytetare. Padyshim që kriminaliteti si fenomen në shoqërinë tonë përfshinë disa sfera të krimeve edhe atë njerzore, ekonomike, politike, psikologjike, ndërsa për të frenuar këtë dukuri masive fataliste në rajonin e Komunës së Tetovës, policia duhet të organizojë një sistem masash sa më efikase kundër tij.

Policia si një forcë e pushtetit shtetërorë ka për detyrë zbatimin e ligjit me rigorozitet, ruajtjen e qetësisë dhe rendin publik, mbrojtjen e jetës, lirinë dhe të drejtat themelore të individit, zbulimin dhe parandalimin e krimit, duhet të kontribuoj në uljen e frikës dhe të rrisë besueshmërinë tek komuniteti si dhe të japë ndihmë dhe të jetë gjithmonë në shërbim të publikut pa dallim gjinie, race, religjioni apo etniteti.

Qëllimi

Kriminaliteti si një dukuri e rezikshme shoqërore me natyrën e vetë shkatëruese i cili paraqitet si një fushë ndërlidhëse që përfshinë veprën dhe kryersin e saj, viktimën dhe reaksionin që shkaktojnë sjelljet e tilla, si dhe fenomenin që kombinon tre kritere që kanë për qëllim interesin personal, shifrat e errëta dhe egon, është kolapsi i cili nxiti interesat e mia që të elaboroj këtë punim shkencorë.

Për vetë faktin e disa krimeve të rënda që janë kryer kohët e fundit në vendin tonë, arrimë në konkluzion se krimi i organizuar përdor metoda të sofistikuar, godet në kushte dhe rrethana të caktuara madje në të shumtën e rasteve edhe të befasishme, andaj për tu arritur profikasia e parandalimit të këtij fenomeni, luftimi duhet të bëhet në mënyrë ultimative nga e gjithë elita intelektuale ku përfshihen juristët, forcat policore të të gjitha niveleve, institucionet e drejtësisë, sociologët, kriminologët, psikologët etj.

Për të arritur objektivin e punimit do të zërthej disa koncepte mbi policinë, misionin dhe verzionin, detyrat institucionale të saj, autorizimet policore, nivelet e organizimit, parimet të cilat udhëheqin veprimtarinë si dhe në veçanti do të fokusohem tek statusi dhe roli i policisë kundrejt këtij fenomeni të cilët çdo ditë përballen me diversitete vështirësish.

Veçanërishtë në punimin tim shkencorë do të përqendrohem në hulumtimin e shkaqeve të ndryshme të cilat janë indikatorë kryesorë për nxitjen e kriminelëve në kryerjen e veprave penale në përgjithësi e veçanërisht në ato që sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë kategorizohen si vepra penale të rënda siç janë: larja e parave, trafikimi i substancave të ndryshme narkotike, trafikimi me njerëz, vjedhjet dhe llojet e tyre, viktimat e vrasjeve, trafikimi me njerëz etj. Gjithashtu do të koncentrohem në studimin e statistikës, dinamikës, njohjen e personalitetit të kryersve me tipologjinë, klasifikimin e tyre si dhe format e manifestimit të kriminit dhe sjelljeve delikuede në përgjithësi.

Pa dyshim që qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë veprimesh të ndryshme kriminale ku përfshihen shumë strategji, aktivitete dhe masa të ndërmara në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe mirë të organizuara nga ana e policisë së shtetit, me të cilat bëhen përpjekje të menjahohen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtëpërdrejta ose të tërthorta të sjelljeve të cilat dëmtojnë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të një vendi.

Metodologjia e hulumtimit

Për hulumtimin, kërkimin, studimin dhe elaborimin e rasteve lidhur me këtë punim shkencorë do të shfrytëzohen këto metoda:

Metoda Krahasuese – Kjo metodë do të shfrytëzohet për krahasimin ligjor të dispozitave dhe të drejtave, autorizimeve dhe obligimeve respektivisht kompetencave që i kanë organet policore si rjedhojë e punës që bëjnë, gjithashtu kjo metodë do të shfrytëzohet për krahasimin e përgjegjësive që i kanë nëpunësit e policisë me organet e prokurorisë dhe gjyqësisë.

Poashtu me anë të kësaj metode do të krahasoj bashkpunimin e ndërsjellë të po të njejtave institucione për po të njejtat krime dhe do të pasqyroj përmes raporteve statistikore eficientë që arrijn me anë të bashkëpunimit komëtarë dhe ndërkombëtarë në numrin e rritjes dhe uljes së veprave të rënda penale nga viti 2013-2018. Gjithashtu do të krahasoj evaulimin e policisë nga shoqëria skllavopronare e deri tek policia në shoqërinë bashkëkohore apo policia moderne dhe krijimin e policisë në Republikën e Maqedonisë pas shpërbërjes së regjimit komunistë të ish-Republikave Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Metoda Analitike – Kjo metodë do të shfrytëzohet në lidhje me analizën e funksionimit të organeve policore në rajonin e Tetovës, transparencën, strategjitë, respektimin e kodit të etikës dhe efikasitetin e tyre në parandalimin e kriminalitetit si dhe hetimet që bëjnë sipas autorizimeve që u takojnë gjithmon të bazuara në dispozita pozitive ligjore. Për më tepër do të bëjë analizë se nga cilat grup moshë dhe gjini manifestohen më shumë këto sjellje devijante dhe kush janë ato faktorë të cilët i degjenerojnë dhe drejtojnë kah këto dukuri negative.

Metoda Statistikore – Kjo metodë do të shfrytëzohet për të përcaktuar të dhëna statistikore vjetore të marra nga Ministria e Punëve të Brendëshme dhe Sektori për Punë të Brendëshme në Gostivarë dhe Tetovë për periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2018 të cilat të dhëna do të pasqyrojnë trajektoren e rritjes apo zvogëlimit të kriminalitetit në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, si dhe do të raportoj se si kanë proceduar rastet konkrete nga sektori i policisë në prokurori dhe gjykatë.

Kapitulli I

1. PËRKUFIZIMI, ZHVILLIMI HISTORIK, ETIKA, KONTROLLI, TRANSPARENCA E POLICISË, DHE FAKTORËT E KRIMINALITETIT

1.1. Nocioni i policisë

Policia është organ publik i krijuar në bazë të ligjit. Puna dhe përgjegjësia e policisë në shoqërinë demokratike është të mbroj jetën e njerëzve, të mbroj integritetin personal të çdo individi, sigurinë dhe pronën e tyre personale, të mbajë rendin dhe sigurinë publike dhe të parandalojë çdo rrezik që mund ti kanoset komunitetit në çdo fatëkeqësi, të ofrojë mbikqyrje në komunikacion, të kontrollojë doganat, të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe ndaj çdo situatë tjetër emergjente, të hetojë dhe të zbuloj veprat penale dhe autoret e kryerjes së tyre gjithmonë duke u bazuar në kornizë ligjore.¹

Duke pasur parasyshë etapat e zhvillimit të shtetit dhe formën e thjeshtë të integritetit shoqërorë, po ashtu edhe policia ka evoluar në periudha të ndryshme kohore duke marrë kuptim më të zgjeruar dhe divergjent gjithmonë duke pasur si element bazë rendin dhe mbrojtjen e shoqërisë. Nocioni i policisë nuk ka ndonjë dallim nga vendi në vend është pothuaj se i njëjtë në të gjitha vendet e botës dhe si term për herë të parë është përdorur në Republikën Franceze në vitin 1250 dhe nënkuptonte tërë veprimtarinë e shtetit duke përfshirë funksionet ligjvënëse, administratën dhe gjyqësorin.²

Nga aspekti etimologjik fjala polici rrjedhë nga anglisht - police ; gjermanisht - polizei ; frëngjisht - police; greke - polis-politea; nëpër vendet nën regjim komunist (ish-Jugosllavi) Maqedoni, Kosovë - militia që rrjedhë nga fjala latine;në Romën e lashtë, militia.³

¹ http://www.kosovopolicia.com/repository/docs/kodi_ietikes.pdf , parë më:11/05/2019

² Fatos Haziri, E Drejta e Policisë, Prishtinë 2010, fq. 33.

³ Ramo.M, Policia dhe Shoqëria, Sarajevë 2008, fq. 13.

1.2. Zhvillimi historik i policisë në botë dhe në Republikën e Maqedonisë

Policia si organ në vete ka egzistuar që nga vetë egzistimi i shtetit duke i zhvilluar format organizative të saj paralelishtë me integrimin dhe evolimin e shoqërisë nga shoqëri të segmentuara (fise), në grupe më të mëdha të cilat kanë shtruar nevojën për ndryshim të veprimtarisë policore duke përdorur mekanizma të reja të cilët do të ishin më efikase për mbajtjen e rendit dhe mbrojtjen e shoqërisë të asaj kohe. Shoqëria e asaj kohe përpos që ka qenë e rrezikuar nga faktorët e jashtëzakonshëm natyrorë dhe egërsirat e ndryshme po ashtu i janë nënshtruar edhe rrezikut nga fiset e tjera brenda bashkësive primitive apo individëve të caktuar të cilët kanë pasur tendencë që të çregullojnë rendin shoqërorë, mirëpo për luftimin, eliminimin ose të paktën neutralizimin e këtyre rreziqeve, mënyra më efektive për mbijetesën e fisit ishte mbrojtja në mënyrë kolektive. Evoluimi policorë ka kaluar nëpër disa etapa zhvillimi nga periudha skllavopronare, periudha e mesjetës, periudha e feudalizmit e deri tek periudha bashkëkohore ose policia moderne. Në periudhën skllavopronare organizimi policorë ka qenë në nivel të ulët dhe mundësia për të siguruar mirëqenien e duhur të asaj shoqërie ka qenë shumë e dobët. Disa vende skllavopronare kishin krijuar disa rregulla në formë të normave të cilat edhe pse ishin të pashkruara kishin vlera të larta dhe çdokush që nuk do ju përmbahej atyre rregullave do të sanksionohej ashpër. Policia, roli dhe funksionimi i saj kanë hapëruar duke patur për bazë evaluimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Në Romë dhe në disa shtete të tjera gjatë ushtrimit ose funksionimit të saj detyrat më të rëndësishme u janë deleguar gjykatave, ushtrisë dhe në shumicën e rasteve në disa shtete të vjetra siç është Greqia, policia ka kryer të gjitha funksionet shtetërore administrative, ligjvënëse dhe gjyqësore. Për shkak të mosperfeksionit të policisë për ruajtjen e rendit shoqëror (integritetit fizik, ruajtjes së pronës) u paraqitën forca ushtarake dhe shërbime të tjera mbrojtëse.⁴

Periudha mesjetare është koha që shënonë periudhën më të errët dhe shoqëria e saj identifikohet si më e egër ndaj kundështarëve të pushtetit fetar, dijetarëve dhe filozofëve që gjithmonë ishin kunder krimit dhe kryerësve të tij. Në këtë periudh funksionet e organizimit shoqërorë i kaluan kishës, mirëpo paraqitja e sistemit monarkik me automatizëm i zhveshi të gjitha funksionet që ishin nën zotërimin dhe pushtetin kishtar. Monarku ushtronte autoritet të plotë dhe suprem mbi të gjitha nivelet e pushteteve duke përfshirë edhe plocinë të cilën e organizonte nën ombrellën e ushtrisë.⁵

⁴ <http://centrum.mk/?p=46>, parë më: 20/10/2018

⁵ Haris Halilović & E. Muratbegović, E Drejta Policore, Sarajevë/Prishtinë 2007, fq. 9-10.

Kur flasim për feudalizmin dhe institucionet juridiko shtetërore të tij, kryesishtë flasim për feudalizmin evropian i cili ndahet në tri perudha, në feudalizmin e hershëm, feudalizmin e vonshëm dhe feudalizmin e zhvilluar ose klasik i cili konsiderohet si periudha e përfundimit të mesjetës dhe si periudha e tranzicionit në të gjitha aspektet shtetërore dhe shoqërore po ashtu edhe në aspektin e policisë. Vlenë të theksohet se në Angli në këtë periudhë monarku ishte shef i shtetit i cili përfaqësonte si brenda dhe jashtë territorit, ishte komandant i ushtrisë dhe forcave tjera të armatosura, kishte të drejtë supreme mbi të gjithë territorin e tij, ruajtjen e rendit dhe qetësisë, zgjedhjen e konflikteve, kishte të drejtën e zbatimit të gjobës ndaj shtetasëve të tij dhe përjashtimit të tyre nga mbrojtja ligjore.⁶

Në Francë prej shek. XV deri ne shek XVIII dukshëm zhvillohet monarkia absolute ku mbreti të gjithë funksionet shtetërore i realizonte nëpërmjet administratës shtetërore e cila përbëhej nga Këshilli Shtetërorë, Këshilli i Financave, Këshilli i Fshehtë dhe një varg institucioneve tjera shtetërore ku përfshihet edhe sistemi i policisë sekrete dhe financiare i cili ka qenë shumë i zhvilluar.⁷

Zhvillimi i përgjithshëm i Anglisë periodizohet në tri faza, ku faza e fundit shënon ndryshime të mëdha shoqërore politike dhe njihet si faza e parë e liberalizimit. Në këtë fazë ndodhi një konflikt midis pushtetit shtetëror dhe banorëve anglez të cilët kërkonin decentralizimin e këtij pushteti dhe e detyruan mbretin anglez që në vitin 1215 të nënshkruante aktin më të rëndësishëm Magna Carta Libertatum që do të garantoheshin të drejta dhe liritë e qytetarëve anglezë dhe do i nënshtroheshin ligjit si të barabartë.⁸

Policia në shoqërinë feudalistike ka vepruar si organ në vete për shkak se në këtë periudhë bëhet ndarja e funksioneve dhe policia u emëruar si “Forca të Rendit”. Zhvillimin më të hovshëm policia e arrinë pas Revolucionit Borgjez-Francez në vitin 1789 ku në këtë periudhë policia u formalizua si sistem zotimi për ruajtjen dhe rendin e siguris publike nëpër rethina dhe komuna. Pas ndryshimeve demografike nëpër qytetet e mëdha europiane ndryshime rrenjësore pësoi edhe policia për shkak të rritjes së kriminalitetit, kjo nxiti shtetet më të mëdha të europës që të nxitojnë me organizimin sa më profesional të policisë për tu ballafaquar me të gjitha fenomenet destruktive të shoqërisë bashkëkohore. Për herë të parë policia si ministri apo në kuadër të ministrisë është paraqitur dhe ka funksionuar ne vitin 1796 në Francë (e cila u emërua

⁶ Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë 2009, fq.103-4,114.

⁷ Po aty, fq.159-160.

⁸ Aurela Anastasi, Historia e Institucioneve, Tiranë 1998, fq.249,250.

si polici nazionale) ku më vonë e njehta polici do të riemërohej ruajtës i paqes dhe sigurimit kombëtarë dhe u nda në polici gjyqësore dhe administrative. Krijimi i policisë si institucion në Francë shërbeu si model për të gjitha policitë e tjera në Europë ku pastaj kohë pas kohe pësonin ndryshime në zhvillimin e saj për të ju përshtatur dhe siguruar të gjitha nevojat dhe lirinë qytetare të çdo individi dhe institucioni.⁹

Pas një gjendje të rëndë të shfaqjes së kriminalitetit që pësoi Anglia, në vitin 1285 për mbrojtjen dhe luftimin e kriminalitetit ajo vendosi statusin e mirkuptimit të Winchesterit i cili thotë që secili qytetarë i aftë fizikisht të posedojë armë, secili qytetarë të ofroj ndihmë dhe të asistojë në mbrojtjen e sigurisë qytetare dhe të formojë sistemin shiko dhe vëzhgo natën dhe ditën në zona të ndara. Kështu sistemi i vëzhgimit filloi të zgjerohej dhe u krijuan mekanizma më efikase për mbrojtjen e rendit publik.¹⁰

Mirëpo në fund të shekullit 18 shumë familje filluan të migrojnë nëpër qytete industriale në kërkim të punës, gjë e cila shkaktoi trazira të mëdha shoqërore dhe si pasojë e këtyre ndryshimeve mbrojtja nga kujdestarët që patrullonin e kishte humbur efektivitetin, prandaj njerëzit paguanin dikë që të kryente punën në vend të tyre që në shumicën e rasteve edhe e keqpërdornin. Mbase ky sistem nuk ishte shumë i mirëpritur, në Angli në fillim të shek.19 u krijuan 9 organizata që do të zbatonin ligjin në hapsira të caktuara. Mirëpo edhe këto organizata nuk e kordinonin punën mes vete dhe shpesh garonin midis tyre në kërkim të kriminelëve, kështu që Ministri i Punëve të Brendshme Robert Peel në v.1822 e miratoi ligjin mbi përmirsimin e cilësisë së punës së policisë. Kjo masë kushtëzoi themelimin e organizatës së parë policore e cila kishte për qëllim parandalimin e veprave penale ose të ishin sa më afër vendit ku kryheshin veprat penale në mënyrë që të arrsestonin kryersit e veprave penale. Ky sistem bazohej në parimet ushtarake dhe rregulla të ashpra. Sipas modelit të Peelit në vitet e 50 të shekullit 19 u themeluan edhe stacionet e para të policisë në Boston, Nju Jork dhe në Filadelfi kurse në vitet e 70 shumica e qyteteve kishin stacione të policisë. Kështu u themelua një polici moderne, e integruar që ishte 24 orë në shërbim të ruajtjes së rendit, qetësisë dhe parandalimit të kriminalitetit.¹¹

Policia në shoqërinë bashkëkohore konsiderohet si kryevepër e shtetit dhe simbol i fuqishëm i pushtetit. Njejtë si në të gjitha shoqëritë tjera duke filluar nga shoqëria

⁹ <http://centrum.mk/?p=46>, parë më: 26/10/2018

¹⁰ Fatos Haziri, E Drejta E Policisë, Prishtinë 2010, fq. 36.

¹¹ Fatos Haziri, E Drejta E Policisë, Prishtinë 2010, fq. 36.

skllavopronare e deri ne shoqërinë bashkëkohore, policia shquhet si i vetmi instrument shtetëror i fuqishëm mbrojtës.

Policia si organ në vete dallon nga organet tjera jo vetëm prej uniformës ku qartazi shihen mjetet e dhunëshme por edhe nga kompetencat e tjera që zotëron ne raste të caktuara ligjore. Shoqëria bashkëkohore kërkonë që roli, funksioni dhe operacionet e policisë të jenë sa më të buta, humane dhe të zhvillohen gjithmonë në përputhje me legjislacionin vendas dhe konventat tjera nderkombëtare për shkakë se funksioni dhe veprimet e tjera të policisë ndërlidhen drejtë për së drejti me rregullimin politikë dhe shoqërorë të vendeve të caktuara nacionale. Në çdo shoqëri bashkëkohore policia është pjesë e sistemit të drejtësisë penale të vendit dhe si e tillë është e pazëvendësueshme në shkencën procedurale. Në çdo fatkeqësi qoftë natyrore apo e shkaktuar nga shoqëria, policia gjithnjë qëndronë në vijën e parë të frontit për dallim nga të gjitha institucionet tjera. Shoqëria bashkëkohore kërkon që policia të mos ketë rolin e shkaktimit të frigës ndaj qytetarit por të jetë bashkëpunues për të siguruar lirinë absolute, integritetin, pronën personale të tij dhe shoqërisë në tërësi, megjithatë policia nuk mund ti tejkalojë kompetencat e saja ligjore, nacionale dhe nderkombëtare dhe nëse një gjë e tillë ndodh atëherë ajo duhet ti nënshtrohet përgjegjësisë qoftë si polic individualë apo si tërësi organizative.¹²


Edhe policia në Republiën e Maqedonisë njësoj si në të gjitha shtetet e tjera, në periudha të ndryshme kohore ka pësuar ndryshime të shumta në zhvillimin e formve organizative të saj, në zgjerimin e strukturës policore, në ndarjen dhe centralizimin e departamenteve, përcaktimin e sektorëve etj.

Në kohën e Republikave Socialiste Federative të Jugosllavisë si pjesë e planit federativ për siguri publike në Maqedoni dhe në Republikat tjera Socialiste ka vepruar milicia. Mirëpo për shkak të papërgaditjes për menaxhimin e krizave të ndryshme të asaj kohe dhe detyrave tjera të veçanta milicia e asaj kohe nuk ka qenë e mjaftueshme, andaj më 13 Mars të vitit 1981 Sekretariati Republikan i Republikës Socialiste në Maqedoni formoi njësitin e parë special që e emëroi Njësitin Tigër. Në vitin 1991 me pavarësinë dhe shpalljen e Maqedonisë si Republikë , u adoptua modeli perëndimor dhe milicia u transferua dhe u riemërua polici.¹³

¹² <http://centrum.mk/?p=46> , parë më: 07/11/2018.

¹³ <https://mk.wikipedia.org/wiki>, parë më:04/01/2019

Policia pas shpalljes së Maqedonisë si Republikë në vete ka pësuar ndryshime të mëdha të kohë pas kohëshme në fushën strategjike, në format organizative të sajë duke i ndarë kompetencat dhe përgjegjësitë e punëve të policisë në departamente dhe sektore të ndryshme, siç shihet në organogramin e poshtëm.¹⁴



¹⁴

[http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%202014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%202014_10_2015-1.pdf), parë më: 12/01/2019

BIRO PËR SIGURINË PUBLIKE

ZV. DREJTORI I ZYRËS PËR SIGURINË PUBLIKE

- Qendrat rajonale për punët kufitare
1. Qendra rajonale për punët e kufirit në veri.
 2. Qendra rajonale për punët e kufirit në lindje.
 3. Qendra rajonale për punët e kufirit në jug.
 4. Qendra rajonale për punët e kufirit në perendim.

DEPARTAMENTI PËR POLICINË E UNIFORMUAR

- Sektori për punë policore me kompetencë të përgjithshme dhe të veçantë.
1. Njësia e rendit dhe paqes publike dhe parandalim.
 2. Njësia për tubime publike dhe gara sportive.
 3. Njësia për përgatitjen dhe trajtimin në situatën komplekse të sigurisë dhe gjendjen e krizës.
- Sektori për punët e trafikut.
1. Njësia e Trafikut dhe Parandalimit.
 2. Njësia mobile për sigurinë në komunikacionin rrugor.
 3. Njësia e Inxhinierisë Trafikut.

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE TË KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

- Sektori për operacionet kufitare.
1. Njësia për krimin ndërkuftar dhe migracionin.
 2. Njësia e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe operacioneve të përbashkëta.
- Sektori për kontrollin dhe mbështetjen e kufijve.
1. Njësia e Kontrollit Kufitar dhe Mbikqyrjes Kufitare.
 2. Njësia mbështetëse.
- Njësia e të Huajve dhe Ripranimi.
 - Njësia mobile për masat kompensuese.
 - Sektori për Raportimin dhe Koordinimin e Kushteve.

DEPARTAMENTI I PUNËVE TË PËRBASHKËTA DHE MENAXHIMI ME BURIMET NJERZORE

- Sektori për punët ligjore dhe mbrojtja e të dhënave personale.
1. Departamenti i Çështjeve Ligjore.
 2. Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

NJËSIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, STANDARDEVE DHE KONTROLLIT TË CILËSIVE

- Sektorët për punë të brendshme
1. Sektori i punëve të brendshme në Shkup.
 2. Sektori i punëve të brendshme në Bitoll.
 3. Sektori i punëve të brendshme në Veles.
 4. Sektori për punë të brendshme në Kumanovë.
 5. Sektori i punëve të brendshme në Ohër.
 6. Sektori i punëve të brendshme në Strumicë.
 7. Sektori i punëve të brendshme në Tetovë.
 8. Sektori i punëve të brendshme në Shtip.

DEPARTAMENTI I POLICISË KRIMINALE

- Sektori për krime të përgjithshme dhe të dhunshme
1. Njësia për pronë dhe krim të dhunshëm.
 2. Njësia për gjak dhe delikte seksuale.
- Sektori për Krimin Ekonomik dhe Korrupsionin
1. Njësia e krimin ekonomik.
 2. Njësia Anti-Korrupsion.
- Sektori për trafikim ilegal të narkotike dhe mallrave të rrezikshëm
1. Njësia për trafik të paligjshëm të drogës.
 2. Njësia për trafikim ilegal të armëve, mallrave të Rrezikshme dhe Materialeve Radioaktive.

DEPARTAMENTI PËR ANALIZËN DHE RAPORTIN E INTELIGJENCËS KRIMINALE

- Sektori për Inteligjencë Kriminale dhe Analizë.
1. Njësia e analizës së inteligjencës kriminale.
 2. Njësia për burime të fshehura të informacionit njerëzor.
- Sektori për Analizë Strategjike dhe Raporte.
1. Njësia e Analizës Strategjike.
 2. Njësia për hulumtim dhe dokumentim statistikor.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERZORE DHE TRAJNIMIT

- Sektori për punët ligjore dhe mbrojtja e të dhënave personale.
1. Departamenti për menaxhimin e burimeve njerëzore.
 2. Njësia për Trajnimin dhe Zhvillimin e Stafit dhe Përfaqësimit komuniteteve dhe barazisë gjinore*.

* [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%2014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%2014_10_2015-1.pdf) parë më:16/01/2019

SHËRBIMET QËDRORE POLICORE

DEPARTAMENTI PËR SHUARJEN E KRIMIT SERIOZ

- Departamenti për mirëmbajtje, logjistikë materiale teknike dhe dokumentim.
- Sektori për operacione të fshehta.
 1. Njësia për oficerët e fshehtë të policisë.
 2. Njësia e Monitorimit të Komunikimeve.
 3. Njësia e monitorimit dhe dokumentimit.
 4. Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.
 5. Departamenti i Mbështetjes Teknike dhe Dokumentimit.
- Sektori për Hetimin Kriminal.
 1. Njësia e krimit financiar.
 2. Njësia e Korrupsionit.
 3. Njësia për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve.
 4. Njësia e Krimit të Rënda dhe Terrorizmit.
 5. Njësia për trafik të paligjshëm të drogës.
- Sektori për Inteligjencë Kriminale dhe Analizë.
 1. Njësia e Inteligjencës Kriminale dhe Njësia e Analizës.
 2. Njësia për burime të fshehura të informacionit njerëzor.

DEPARTAMENTI I NJËSIVE TË AVIACIONIT

- Njësi helikopteri për qëllime të veçanta.
 1. Njësia e mirëmbajtjes së helikopterit për qëllime të veçanta.
- Njësi helikopteri për qëllime policore.
 1. Njësia për helikopterë të mirëmbajtjes teknike për qëllime policore.

DEPARTAMENTI PËR OPERACIONE TË VEÇANTA POLICORE

- Njësia për Trajnim dhe Mbështetje.
- Njësi për vendosjen e shpejtë.
- Njësi e veçantë e detyrës.
- Sektori për Bashkëpunimin Policor Ndërkombëtar.
 1. Departamenti për Zyrën Qendrore Kombëtare - INTERPOL Shkup.
 2. Departamenti për Europol.
 3. Departamenti i kërkimit.
- Sektori për krimin kibernetik dhe dixhital mjeko-ligjore.
 1. Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike.
 2. Departamenti për Mjekësinë Ligjore Dixhitale.
- Baza e policisë në aeroport.
- Njësia për qen zyrtarë.

DEPARTAMENTI PËR KONTROLL DHE MENAXHIM TË CILËSISË***

DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE TË CAKTUARA

- Departamenti për zhvillim dhe punë teknike administrative Njësia e Komunikimit dhe Koordinimit.
- Sektori për Sigurimin Parandalues të Personave dhe Objekteve.
 1. Departamenti për mbrojtje parandaluese.
 2. Departamenti i mbrojtjes kimike dhe biologjike dhe rrezatimit.
 3. Departamenti për anti-diversioni, mbrojtje-siguria elektroteknike dhe mbrojtja e PP.
- Sektori për Sigurinë e Personave.
 1. Njësia e Sigurisë e Presidentit të R.M.V.
 2. Njësia e Sigurisë së Kryetarit të Kuvendit të R.M.V.
 3. Njësia e Sigurisë së Presidentit të Qeverisë R.M.V.
 4. Departamenti për sigurimin e Ministrave, ish-Presidentëve të R.M.V. dhe personave të tjerë.
 5. Departamenti për Sigurimin e Delegacioneve të Huaja.
 6. Njësia e para-nisjes dhe siguria e përcjelljes së trafiku.
- Sektori për ofrimin e objekteve me interes shtetëror.
 1. Departamenti për Siguri i Kuvendit të R.M.V.
 2. Njësia e Sigurisë së Qeverisë së R.M.V.
 3. Departamenti i Sigurisë së Ministrive.
 4. Departamenti për sigurimin e ndërtesave të banimit dhe objekteve të tjera me interes shtetërorë.
- Sektori për sigurimin e përfaqësive konzulare diplomatike, objekteve me siguri të veçant, sigurimi hekurudhave.
 1. Departamenti për Siguri të përfaqësive konzulare.
 2. Sigurimi i Departamentit të Trenave.
 3. Njësia për sigurimin e objekteve me rëndësi të veçantë dhe sigurimi i trenave.

DEPARTAMENTI PËR PROVAT KRIMINALE TEKNIKE DHE RAPORTET E EKSPERTËVE

- Sektori për identifikimin kriminal të personave.
 1. Njësia për regjistrimin dhe identifikimin kriminal në fytyra.
 2. Departamenti për gjurmët e vijave papilare dhe pranimit dhe zgjedhja e materialit biologjik.
 3. Departamenti i sanimit të gishtave.
 4. Departamenti i Hetimeve Biologjike dhe ADN identifikimi.
- Sektori për Hetimet Penale dhe Laboratorike.
 1. Departamenti i Toksikologjisë dhe i Drogave.
 2. Departamenti i mikro-gjurmëve.
 3. Departamenti i mekanoskopisë dhe balistikës.
 4. Departamenti për shqyrtimin e dokumenteve të diskutueshme.
- Sektori për teknikën kriminale operacionale.
 1. Departamenti për analizë të pajisjeve digjitale dhe mediave.
 2. Departamenti për Zhvillim dhe Teknik Kriminalistik mbështetje-

** [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%2014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%2014_10_2015-1.pdf), parë më:21/01/2019

*** [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%2014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%2014_10_2015-1.pdf), parë më:21/01/2019

1.3. Etika në polici

Etika në përgjithësi është shkencë mbi moralin e cila shqyrtonë kuptimin dhe qëllimin e normave morale. Konkretisht etika është një grumbull parimesh mbi sjelljen e drejtë, një sistem vlerash morale, rregullash dhe standardesh që udhëheqin sjelljen e një personi apo të anëtarëve të një organizate. Etika ka ndikim të drejtëpërdrejtë në jetën e njerëzve dhe është thelbësore për shkak se ajo konceptualisht siguron themelet normative për ligjin dhe politikat, nga të cilat së pari kërkohet vendosja e një baraspeshe për mbrojtjen e rendit publik dhe kushtetues dhe së dyti mbrojtja e parimeve të shtetit juridik për respektimin e të drejtave dhe lirive elementare. Ndonëse të gjitha politikat janë të përfshira në vlerat shoqërore siç është barazia, liria dhe dinjteti të cilat vlera edhe përcaktojnë se kush jemi ne si njerëz, është e domozdoshme që ndërmjet marrëdhënieve të punonjësve të policisë, etikës, ligjit, politikave dhe qytetarëve të ndërtohet një solucion i besimeve që individit të jetë në gjendje ti realizojë këto të drejta në harmoni me rregullat të cilat kërkojnë mosçenimin e segmentit të sigurisë. Duke pasur parasysh se në çdo shoqëri shteti është bartës i sigurisë ai është i obliguar që çdo individ ti sigurojë të drejtat dhe liritë dhe ti shmang rreziqet që mund ti çenojnë këto të drejta të cilët janë elementare dhe kanë ndikim thelbësorë në funksionimin e sistemit të një shteti demokratik. Meqenë se përgjatë një hapësire jetësore në çdo shtet dhe shoqëri egzistojnë individë që me sjelljet dhe veprimet e tyre çenojnë disa segmente të sigurisë dhe lirisë së qytetarëve të cilat njëkohësisht edhe pengojnë që të arihet një rend mirë i organizuar shoqërorë, organet policore për këtë bartin obligim shoqërorë dhe përgjegjësi të veçantë të cilët pikërisht edhe janë të autorizuara që të kryej punët e mbrojtjes së rendit publik dhe atij juridik, gjithmonë duke e realizuar funksionin e saj nëpërmjet fuqisë legjitime. Nëse shteti nuk ofronë nivelin e duhur si dhe përmbushjen e detyrave operative në mënyrë përgjegjëse dhe profesionale arëher nuk mund të flasim për liritë individuale të një shoqërie demokratike. Kur flasim për etikën në kuptimë të ngushtë ndeshemi edhe me termin dentologji. Dentologjia nënkupton një bashkësi principesh, parimesh dhe rregullash morale të cilat kërkojnë respektim të domozdoshëm me dinjtet dhe përkushtim nga çdo i punësuar gjatë ushtrimit të profesionit e sidomos kur flasim për etikën policore, respektivisht kodeksin etik të sjelljeve të nëpunësve policorë.¹⁵

¹⁵ Ramo Masleša, POLICIA DHE SHOQËRIA, Sarajevë/Prishtinë 2008, fq. 183-186.

Policimi etik përbën aspektin kryesorë të strategjive antikorrupsion. Thelbi etik i policimit bazohet në parimet kryesore të jetës publike, siç janë: ligjshmëria, përgjegjshmëria, barazia, paanshmëria, transparenca, integriteti, efica, drejtësia, të cilat së bashku me llogaridhënien, proporcionalitetin në përdorimin e forcës dhe mbrojtjen e interesave publike dhe të individit reflektohen edhe në rregullat e etikës dhe sjelljes në Policinë e Shtetit.¹⁶

Në Republikën e Maqedonisë si dhe në shtetet tjera etika e policisë është e përcaktuar me ligj të posaçëm i cili është emëruar si Kodeksi Etik i Policisë. Në rënditjen ligjore të Kodit të Etikës Policore të Maqedonisë pikërishtë në Nenin 1 të këtij Kodi janë të parapara mardhëniet e sjelljes dhe puna e policisë në përgjithësi, të drejtat themelore të policisë dhe funksioni i saj, mardhëniet e policisë me të drejtën penale dhe organet gjyqësore, kualiteti, procesi i selektimit, puna dhe ushtrimi i zyrtarëve policorë, të drejtat e nëpunësve të policisë etj.¹⁷

(1) Ky Kod përcakton sjelljen, operacionet dhe objektivat e Policisë, bazat ligjore të funksionit të policisë, marrëdhëniet policore me organet e drejtësisë penale, organizimin e policisë, kualifikimet, procesin e zgjedhjes, punësimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë, të drejtat e nëpunësve policorë, ndërhyrjet policore, përgjegjësit dhe kontrollin e nëpunësve policorë, hulumtimet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë duke respektuar parimet bazë dhe rekomandimet e përfshira në Kodin Evropian të Etikës Policore, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 19 shtator të vitit 2001.

(2) Oficerët e policisë duhet t'i përmbahen dispozitave të këtij Kodi.¹⁸

Siç shihet punësimi, përzgjedhja dhe kualifikimet në polici janë specifikuar në mënyrë formale dhe ligjore. Në Kodin e Etikës së Policisë të Maqedonisë thuhet se: Nënpunësit e policisë janë të punësuar në bazë të kualifikimeve personale dhe përvojës në përputhje me kushtet e përzgjedhjes dhe punësimit të përcaktuar me ligj dhe në përputhje me objektivat e punës së policisë. Gjithashtu Kodi i Etikës thotë se: Kualifikimi, përzgjedhja dhe rekrutimi i punonjësve të policisë janë dhënë në përputhje me parimin e profesionalizimit, ligjshmërisë dhe efikasitetin e operacioneve të përcaktuara me ligj. Me këtë ligj poashtu përcaktohet mënyra e punësimit të punonjësve të policisë ku thuhet se: Një polic është i punësuar në bazë të një njoftimi publik sipas mënyrës dhe kushteve që parashihen në këtë ligj dhe se nëpunësit e

¹⁶ Arjan Dymishi, Manuali i Etikës dhe Integritetit Policorë, Tiranë 2016, fq6

¹⁷ „Службен весник на РМ“ бр. 72 од 11.06.2007 година, Neni 1.

¹⁸ <https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Kodeks%20na%20policiska%20etika%2072-07.pdf>, parë më:10/03/2019

policisë gradohen në bazë të nivelit arsimorë, përvojës profesionale në vendin e punës dhe në bazë të vlerësimit vjetorë.¹⁹

Përderisa etika në rolin e policisë është imperativ i domosdoshëm për të përvetësuar e zbatuar të gjitha normat etike gjatë ushtrimit të detyrës së tyre në proporcion me ligjin dhe për të shmangur konfuzionin që mund të krijohet në hapsirë dhe kohë ndërmjet ligjit, vendimit etik dhe veprimit delikuent, nëpunësve policorë ju nevojitet trajnim.

Me Kodin Etik të Policisë në Republikën e Maqedonisë në nenin 16 është përcaktuar se nëpunësit e policisë në të gjitha nivelet janë personalishtë përgjegjës për aktivitetet e tyre, anashkalimet dhe mosveprimet si dhe urdhërat e mara nga eprorët dhe ata që i janë dhënë vartësve, kurse neni 27 i këtij kodi parasheh se trajnimi i punonjësve të policisë, përmes niveleve të ndryshme të edukimit të policisë me precizim të qartë, siguron profil të aftësisë dhe kulturës policore, shkallën e lartë të iniciativës, profesionalizëm gjatë kryerjes së funksionit policorë.²⁰

Trajnimi i etikës tek punonjësit e policisë luan një rol shumë të rëndësishëm sepse ato vazhdimisht mund të gjenden përballë ndonjë situatë apo veprimi specifik në çrastë duhet të marrin vendime. Padyshim që çdo vendim i gabuar ndëshkohet dhe ky ndëshkim do të ishte shumë i padrejtë për punonjësit e policisë në qoftë se ato nuk do të ishin në dijeni për pasojat e vendimeve të gabuara. Që punonjësit e policisë të marrin vendime adekuatë, të drejta dhe të kuptojnë rëndësinë e vendimarrjes, si parakushtë e kanë njohjen dhe përvetësimin e etikës nga e cila mësojnë se si të eliminojnë pengesat, si të mposhtin presionin që mund të vij si pasojë e një subjekti njerëzorë të konfliktuar dhe si të marrin vendime që janë etike dhe të efektshme. Natyrishtë që përpara se punonjësit e policisë të ballafaqohen me një situatë të tillë ato paraprakishtë duhet të verifikojnë se a është i ligjshëm vendimi që do të marrin, se ky vendim a do të shkelte rregullat, ligjet dhe kushtetutën, a do të ishte i drejtë, i barabartë për të gjithë dhe a do të ishte në pajtueshmëri të plotë nga publiku dhe eprorët. Trajnimi i etikës është një praktikë e përhapur në vendet demokratike dhe synon krijimin e strategjive ose ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për parandalimin e korrupsionit pavarësishtë nivelit të tij.²¹

¹⁹ http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/02/Policija-Merit-Sistem_Studija_Vanchoski_EPI_MK.pdf?fbclid=IwAR1V3IoFLkdAapyjUjUrL8xqM1mrmBwKzZ_jsMgS5NR2R7TWW9kaXNxxx4c, parë më:17/04/2019.

²⁰ „Службен весник на РМ“ бр. 72 од 11.06.2007 година, Neni 16,27.

²¹ A.Dyrmishi, Manuali i Etikës dhe Integritetit Policorë, Tiranë, fq7-9,18,25

Punonjësit policorë janë individë të cilët në kuadër të ligjit janë të pajisur me forcën për të realizuar diçka pozitive dhe në shërbim të njerëzve, duke i fokusuar dhe zbatuar aktivitetet e tyre gjithmonë mbi fuqinë ligjore dhe në emër të shtetit. Edhe pse sistemi operativ policorë udhëhiqet dhe funksionon në bazë të kornizave ligjore gjithsesi duhet të realizohet mbikqyrja e ligjshmërisë sepse nuk përjashtohet mundësia që fuqia e saj edhe mund të marrë përmasa të rrezikshme në raport me qytetarët duke aplikuar masa represive dhe duke i tejkaluar veprimet që u janë autorizuar me ligj. Përdorimi i forcës nga personat që janë në shërbim të ligjit lejohet vetëm në rastet e domosdoshme dhe në masë të duhur për të përmbushur detyrën e tyre. Detyrat policore duhet të përmbushen në mënyrë sa më profesionale asisoji që keqpërdorimet e autorizimeve të evidentohen apo të zvogëlohen sepse çdo jo profesionalizëm, jo specializëm, çdo mungesë e dimensionit etik dhe mungesë dinjiteti lënë gjurmë të thella në shërbimin policorë. Nëpunësit policorë duhet të veprojnë në mënyrë të aftë, të ndershme, të paanëshme dhe dinjitoze.²²

Në raport me qytetarët nëpunësit policorë duhet të kenë integritet stabil dhe të punojnë drejtë siç është paraparë në nenin 21 të Kodit Etik të Policisë së R.M-së i cili thotë:

(1) Me qëllim të ruajtjes së integritetit të qëndrueshem të policisë, si dhe funksionimit të duhur të Policisë së Shtetit, policia në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, në të gjitha nivelet brenda organizatës policore vendos masa efektive për parandalimin efektiv dhe luftimin e korrupsionit përmes përcaktimit të sjelljes korruptive dhe krijimit të strukturave organizative dhe mekanizmave të kontrollit për të luftuar korrupsionin. (2) Nëpunësit policorë nuk duhet të lejojnë të kenë varshmëri materiale dhe varshmëri të tjera nga persona apo autoritete të tjera. (3) Nëpunësit e policisë nuk guxojnë ti shfrytëzojnë autorizimet e tyre për interesa personale.²³

Punonjësit e policisë nuk guxojnë ta shfrytëzojnë pozicionin apo profesionin e tyre për interesa personale përkundrazi ato duhet ti shmangin konfliktet e interesit sepse ky veprim cenon seriozishtë vlerat fundamentale në të cilat shtrihet një shoqëri dhe ofendon sistemin e rendit publik dhe qytetarët. Poashtu ato nuk duhet të lejojnë të korruptohen e as të korruptojnë sepse korrupsioni përbenë një vepër të rënde penale, natyrishtë se çdo vepër e rëndë penale parashikohet në mënyrë të veçantë nga ligji. Lufta kundër korrupsionit kërkon zbatimin e kodeve anti korrupsion për kryerjen e saktë dhe të përshtatshme të detyrave policore si dhe mekanizma efektive që do të garantojnë hetime të drejta dhe të plota dhe do të sjellë para

²² Fatos Haziri, E Drejta Policisë, Prishtinë 2010, fq. 75-76.

²³ „Службен весник на РМ“ бр. 72 од 11.06.2007 година, Neni 21, (1-3).

drejtësisë të gjithë ato që përfshihen në korrupsion dhe pandershmëri pa frikë, favorizëm, afeksion etj.²⁴

Kodi i Etikës së Policisë është miratuar me ligj, me qëllimin për të luftuar korrupsionin dhe forcuar integritetin në polici. Kodi i Etikës përcakton detyrimin e punonjësve të policisë që të luftojnë me vendosmëri korrupsionin i cili konsiderohet prioritet i rëndësishëm dhe të denoncojnë çdo akt të shfaqjes së korrupsionit dhe abuzimeve.²⁵

Së fundmi vimë në konkluzionë se etika në funksionin e detyrës zyrtare në tërësi apo të një nëpunësi zyrtarë zë vendin kyç për të krijuar raporte profesionale në raportë me individin apo komunitetin në tërësi. Etika punonjësit policorë i kultivon me vetëdijen për ti kuptuar drejt vlerat morale, për ti respektuar me maturi, paanëshmëri, përgjegjeshmëri, neutralitet dhe mirësjellje parimet të cilat përcaktojnë rolin e policisë në shoqëri, si edhe i pajis nëpunësit policorë me aftësi drejtuese apo udhëheqëse. Policia si zbatues i ligjit është krijuar për mbrojtjen e ligjit dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve në përgjithësi të cilat janë të garantuara me Kushtetutë dhe struktura e saj është e organizuar në mënyrë profesionale ashtu që të gëzojë respektin dhe besueshmërinë e plotë nga publiku, andaj nëpunësit policorë si zbatues të ligjit duhet të jenë nën vetëdije të plotë për kufizimin e autorizimeve që u janë dhënë, vendimeve që marrin gjatë ushtrimit të profesionit si dhe pikë synimi primarë i tyre të jetë eficaenca.

1.4. Kontrolli i policisë dhe transparenca

Policia e shtetit është shërbim policorë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ajo është institucion i administratës publike, strukturë e Ministrisë së Brendëshme. Ministria e ka përgjegjësinë të sigurojë efektivitetin dhe eficaencën e punës së policisë, mirëpo në përgjithësi Ministri nuk përfshihet në asnjë mënyrë dhe formë në operacionet, planifikimin, organizimin dhe drejtimin e operacioneve policore. Misioni i Policisë është që të ruaj rendin dhe sigurinë publike në përputhje me legjislacionin në fuqi duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.²⁶

²⁴ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë(OSCE),fq. 17,18,19.

²⁵ <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12305.pdf> , parë më: 30/05/2019

²⁶ <https://shtetiweb.org/2012/09/21/policia-e-shtetit/>, parë më 05/06/2019

Kontrolli i policisë është segment shumë i rëndësishëm për funksionimin e policisë së çdo shteti demokratik sepse veprimet e paligjshme dhe të pandërgjegjshme të policisë e dëmtojnë imazhin dhe besimin e qytetarëve. Njihen dy forma të kontrollit të policisë: kontrolli i jashtëm dhe kontrolli i brendshëm. Kontrolli i jashtëm i policisë ka të bëjë me funksionin penal dhe aktivitetet e policisë, me kontrollin e veprimeve të policisë, me rastin e grumbullimit të dëshmive me qëllim të inicimit të procedurës penale. Kontrolli i jashtëm i policisë më së shumti varet nga ankesat e qytetarëve kundrejtë sjelljes së pjsëtarëve të policisë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare gjegjësishtë ankesave për tejkalim dhe keqpërdorim të autorizimeve. Kurse kontrolli i brendshëm i policisë nënkupton kontrollin që e bënë vetë policia brenda institucionit policorë ose vetëkontrollin. Karakteristikë e vetëkontrollit apo kontrollit të brendshëm është zbulimi i policëve të cilët kanë tejkaluar dhe keqpërdorur autorizimet e tyre dhe të zbulohen arsyet që kanë shtyrë drejt veprimeve të tilla. Nëpërmjet të kontrollit të brendshëm realizohet mbrojtja e qytetarëve nga keqpërdorimet individuale që mund të vinë si pasojë e papërgaditjes profesionale të ndonjë nëpunësi policorë apo nga pretendimi i përfitimeve personale.²⁷

Sipas nenit 9 të Ligjit për Policinë e Maqedonisë, kontrolli i brendshëm i policisë realizohet në këtë menyrë: (1)Ministri i punëve të brendshme (në tekstin e mëtejme: Ministri) pranë Qeverisë Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Qeveria) duhet të paraqes një raportë me shkrim mbi punën që e kryen policia të paktën një herë në vit. (2)Ministri i paraqetë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe trupave punues raportin me shkrim për punët që i kryen policia të paktën nje herë në vit. (3)Ministria publikon raportin me shkrim për punët që i kryen policia, në mënyrë të qasëshme për publikun (faqe interneti, media etj).²⁸

Ankesat zakonishtë mblidhen dhe analizohen nga policia dhe grupet e jashtme të ekspertëve për të evidentuar shkaqet kryesore të shkeljeve dhe identifikimin e oficerëve për të cilët bëhen vazhdimishtë ankesa. Prandaj sistemi i mbikqyrjes është pjesë shumë e rëndësishme në veprimtarinë e policisë dhe ndihmonë për evidenimin e tendencave, për përmirsimin e trajnimeve dhe sigurinë për punonjësit e policisë si dhe ndihmonë në marjen e informacionit në kohë rreth strukturës që trajton çështjet me interes publik. Raportet e sakata dhe në kohë ndihmojnë në krijimin dhe ruajtjen e besueshmërisë te policia dhe publiku. Praktika

²⁷ E. Muratbegović & H. Halilović, E Drejta Policore, Sarajevë/Prishtinë 2007, fq.22-24.

²⁸ <https://www.pravodiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-politsija-03-11-2006.pdf>, më:15/06/2019

mbikëqyrëse duhet të nxisë ndjenjën e veshjes me autoritet, mbështetjen dhe zhvillimin personal të individëve.²⁹

Ligji për Policinë e Republikës së Maqedonisë në nenin e 8 përcakton se ankesë kundër nënpunësit të policisë mund të parashtrahet siç vijon: (1)Kur personi ndaj të cilit zbatohen kompetencat e policisë në pajtim me këtë ligj pretendon se punonjësi i policisë i ka shkelur liritë dhe të drejtatë tij, ai ka të drejtë ankese në polici. (2)Policia është e detyruar të kontrollojë pretendimet në ankesën e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni dhe brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të ankesës me shkrim të informojë parashtruesin për masat e marra.³⁰

Institucionet mbikëqyrëse përfshinë ekzekutivin (Qeverinë), kontrollin policorë, kontrollin financiarë dhe mbikqyrjen horizontale nga agjensitë ekzekutive apo qeveritare. Si institucion është legjislativi gjithashtu edhe deputetët e zgjedhur nga populli me anë të komisioneve të ngritura hetimore parlamentare, policia llogari mund të japë edhe para organeve gjyqësore, komisionet e të dejtave të njeriut, bordet e ankesave civile, avokatit të popullit etj. Megjithëse qytetarët ja japin policisë me dëshirën e tyre pëlqimin për përdorimin e monopolit të forcës, për ruajtjen e qetësisë publike, kontrollin shoqërorë, dhe zbatimin e lirive të tyre qytetare, politike dhe ekonomike, shërbimet policore demokratike e kanë për detyrë që pushtetin e tyre ta kenë të kontrolluar nga publiku nëpërmjet proceseve të llogaridhënies. Për këtë arsye duhen zhvilluar dhe siguruar masat e efektshme për të garantuar integritetin dhe performancën e duhur të personelit policorë. Policia domosdoshmërishtë duhet të konsiderojë të përgjegjëshme veten për punën e saj përpara qytetarëve , eprorëve, shtetit dhe ligjit dhe atë duke patur parasyshtë sjelljen individuale të punonjësve të policisë, strategjitë për operacionet policore, procedurat e emërimit dhe procedurat e buxhetit. Llogaridhënia e nënkupton tërë veprimtarinë e saj duke filluar që nga sjellja e çdo efektivit të saj e deri tek strategjitë e organizimit të operacioneve, procedurat e emërimit etj. Si hierarki policia është e hapur ndaj vëzhgimit të një sërë institucioneve mbikëqyrëse.³¹

Kontrolli është funksion i rëndësishëm për çdo nivel të policisë i cili konsiston në matjen dhe vlerësimin e punës dhe është i lidhur ngushtë me të gjitha funksionet menaxheriale, por në mënyrë të veçantë kontrolli ka lidhje të drejtpërdrejtë me funksionin e planifikimi.³²

²⁹ <https://www.osce.org/sq/secretariat/23807?download=true> parë më: 23/06/2019

³⁰ <https://www.pravodiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-politsija-03-11-2006.pdf>, parë më:25/06/2019

³¹ <https://www.osce.org/sq/secretariat/23807?download=true> parë më: 28/06/2019

³² Fatos Haziri, E Drejta e Policisë, Prishrinë 2010, fq 65.

1.5. Faktorët e kriminalitetit

Kriminaliteti është një fenomen shumë i rrezikshëm, i dëmshëm dhe i ndërlikuar shoqërorë i cili ka egzistuar dhe është zhvilluar krahas shkallës së civilizimit shoqërorë. Fenomeni “Kriminalitet” manifestohet në menyra të ndryshme që ngërthen në vete të gjitha ato sjellje devijante të cilat janë të kundërligjësme dhe që çënojnë, atakojnë ose rrezikojnë vlerat themelore të çdo individi, integritetin fizik ose trupor, jetën e njeriut, pronen, sigurinë dhe lirinë. Këto vlera kanë shtuar nevojën e studimeve shkencore dhe interesimin mbi arsyet që i shtynë disa individë të bëhen kriminelë ose mbi faktorët që kontribuojnë në devijim shoqërorë me qëllim të arritjes së preventivave sa më efikase për frenimin e rritjes së mëtejshme të kësaj dukurie.

Për parandalimin ose së paku zvogëlimin e kësaj dukurie komplekse dhe mjaftë heterogjene duhet të elaborohen të gjitha ato kushte, shkaqe dhe rrethana që e vënë në kontakt njeriun me kriminalitetin të cilat shpjegohen nëpërmjet të disa faktorëve determinues. Këto faktorë në literaturën kriminologjike shpjegohen nëpërmjetë pikpamjeve të shumë autorëve, filozofëve, kriminologëve, psikologëve, sociologëve të cilët etiologjinë kriminale e bazojnë në tre teori të cilat janë: Teoria e faktorit, teoria funksionaliste, teoria e kauzalitetit.

Teoria e faktorit shkaqet e kriminalitetit i bazon në dy versione në atë monist që nënkuptonë shkaktimin e kriminalitetit në shoqëri vetem nga një faktorë kryesorë. Sipas shpjgimit të Lombrosos faktori njeri dhe vetitë e tij biologjike dhe psiqike paraqesin rethanat kryesore që e lidhin individin me kriminalitetin ndërsa rethanat tjera janë të dorës së dytë. Kurse versioni i dytë është pluralist ose i multifaktorëve që shkaktimin e kriminalitetit e shpjegon në më shumë variabla dhe e bazon në rethana shoqërore, ekonomike, familjare etj. Sipas teorisë funksionaliste akcenti i kriminalitetit vihet mbi analizën, organizimin dhe funksionimin e institucioneve shoqërore dhe ndërlidhjeve të tyre reciproke ndërmjet vete dhe shoqërisë së caktuar. Kjo teori shkaqet e kriminalitetit i bazon në lidhjen funksionale të institucioneve shoqërore dhe ndihmesës që ato japin për ruajtjen e baraspeshës shoqërore që luanë një rol të rëndësishëm për parandalimin e sjelljeve devijante. Teoria e kauzalitetit si faktorë të kriminalitetit e cilëson ndërlidhshmërinë e rethanave të drejtpërdrejta në mes shkakut dhe pasojës. Bazuar në pikëpamjet e kësaj teorie si faktorë kryesorë dhe të fuqishëm të cilët nxisin direktë dhe i paraprijnë aktiviteteve të sjelljeve antisociale në shoqëri konsiderohen kushtet, shkaqet dhe shkasat të cilat shkaktojnë kauzalitetin gjithmonë duke u ndikuar nga kushtet e natyrës ekonomike, materiale, sociale, politike, psiqike, familjare etj. Si shkaqe të sjelljes kriminale konsiderohen të gjithë ato rethana që e nxisin individin apo grupin e caktuar

direkt në kriminalitet, si kushte të sjelljes kriminale konsiderohen ato rrethana të cilat intervenojnë në lehtësimin, ndihmesën dhe mundësimin e kryerjes së krimit dhe cilësohen si rrethana plotësuese dhe ndihmëse, kurse shkasi nënkupton ato sjellje kriminale që nxiten në situata të caktuara dhe raste konkrete që mund të paraqitet si pasojë e një veprimi të veçantë momental.³³

1.5.1. Faktorët e jashtëm (objektivë) të kriminalitetit

Përhapja e krimit, format e shumta të viktimizimit dhe numri i madh i viktimave në botën e sotme paraqesin një shqetësim serioz shoqërorë të cilat e minojnë pëlhurën shoqërore duke e zhveshur nga ndjenja e sigurisë e cila njëkohësisht ka nxitur interesim të madhë që etiologjia kriminale dhe ndërveprimet e katër elementeve kyç siç janë viktima, shteti dhe publiku të studjohet në mënyrë sistematike dhe shkencore.³⁴

Faktorët e jashtëm ose egzogjenë janë faktorë shumë të rëndësishëm dhe kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në shtytjen e sjelljeve kriminale dhe kategorizohen në faktorë ekonomik-shoqërorë, faktorë ideopolitikë të kriminalitetit, sociopatologjikë etj. Tek faktorët ekonomik-shoqërorë si rrethana paraqiten, industrializimi, urbanizimi, migrimi i njerëzve, krizat dhe depresionet ekonomike, varfëria dhe papunësia, dhe profesioni ose mjeshtria. Industrializimi nënkupton zhvillimin e hovshëm ekonomik e material i cili njëkohësisht e përshpejtoi edhe procesin e urbanizimit. Ky proces i zhvillimit të hovshëm solli me vete edhe grumbullimin, migrimin e madh të popullsisë nëpër qendra qytetare ku zgjidhja e problemit të banimit, mbrojtja shëndetsore, punësimi, arsimimi i fëmijëve dhe edukimi i qytetarëve të tjerë të ardhur nëpër këto qendra ishte i pamundur ku kjo pamundësi ka paraqitur një vargë pasojash negative që janë shprehur në sjellje të ndryshme antisociale dhe aktivitete kriminale. Gjithashtu faktorë që ndikonë fuqishëm në paraqitjen e kriminalitetit veçanërisht në kohën e krizave dhe depresioneve ekonomike është varfëria e cila rrjedhë nga pamundësia e kyçjes së individëve në punë dhe konsiderohet se krimi është produkt i shtresave të varfëra të popullsisë dhe krimi vjen si rezultat i mungesës së kushteve materiale. Sipas mendimit të disa autorëve si faktor tjerë të kriminalitetit paraqiten edhe profesioni apo mjeshtria. Këtu është fjala për disa lloje profesioneve apo zanatesh të cilët lehtësojnë kryerjen e disa formave të kriminalitetit dhe njëkohësisht ju mundësonë fshehjen e gjurmëve të krimit më lehtë se personat e profesioneve

³³ Halili.R. Kriminologjia, Prishtinë 2007, fq 239

³⁴ Ragip.H, Viktimologjia, Prishtinë 2007, fq 112

të tjera. Megjithatë edhe pse profesioni nuk e krijonë kiminelin nëse ai vetvetiu nuk është i prirur të deformatë profesionin por nga të dhënat e disa statistikave kriminale rezultojnë se disa profesione shmanjin pengesat e kryerjes së krimit dhe mundësojnë fshehjen e fakteve egzistuese. Faktorët ideopolitikë përfshijnë konfliktet e natyrës politike, konfliktet kulturore, fetare, religjioze dhe ndikimin e mjeteve të komunikimit masovik në shoqëri etj. Konfliktet politike përpos që kanë ndikim të madh në kriminalitet politikë ato dukshëm i hapin rrugën edhe kriminalitetit të përgjithshëm me çrastë favorizojnë konfliktet e dhunës, korrupsionin, rryshfetin, krimin e organizuar ku prania e tyre ofronë një varg dukurish dhe sjellje kriminale duke filluar nga krimet më të rënda kundër jetës dhe trupit, e deri tek krimet që kanë të bëjnë me sigurinë, pronën, liritë dhe të drejtat e tyre qytetare. Po ashtu në masë të konsiderueshme si rezultat i kundërthenieve dhe çregullimeve shoqërore-politike vinë edhe konfliktet kulturore. Meqenëse pjesa më e madhe e shtetve dhe shoqërive bashkëkohore kanë qenë të përbëra nga një strukturë multikulturore gjithmonë ka pasur përplasje në mes individëve dhe grupeve të caktara duke u munduar që tua imponojnë sjelljet, qëndrimet, zakonet, rregullat, botkuptimet e veta grupeve apo individëve të caktuar dhe këto mospërputhje dhe kundërshtime midis tyre përherë kanë shkaktuar mosmarveshje dhe konflikte. Si faktor tjetër kriminogjenë konsiderohet edhe lufta e cila i paraprijnë në masë të madhe kriminalitetit në fazën e përgaditjes së luftës, në fazën e zhvillimit të luftës dhe në fazën e pasluftës.³⁵

Faktorë tjerë të fuqishëm që kontribuojnë në masë të konsiderueshme në kriminalitet konsiderohen mjete të komunikimit masiv, shtypi i përditshëm, shtypi i ilustruar, zbavitës, literatura, televizioni, filmi, radio etj. Mjetet e komunikimit masiv në ditët e sotme kanë ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe formimin e personalitetit, konkretisht kur flitet për ndikimin tek brezat e ri ato me paraqitjen e shkrimeve, veprave, emisioneve, filmave dhe përmbajtjeve tjera të cilat kanë vlera të dyshimta morale dhe përmbajtje joadekuate artistike, shkencore, dukshëm nxisin motive të ulëta dhe negative duke i servuar shoqërisë metoda dhe mjete që ngjallin egon për emitim të sjelljes së njejtë kriminale ose për përsosje sipas shkallës së vetëdijes, rrethanave dhe elementeve të tjera që mund ti shërbejnë delikuentit. Si faktorë tjetër kriminogjenë që ndikonë dukshëm në qëndrimet, veprimet dhe sjelljet e ndryshme individuale dhe grupe shihet edhe religjioni dhe sektet ekstreme religjioze. Mësimet religjioze dhe botëkuptimet fetare kanë ndikim të madh në kahjet jetësore të njeriut, sepse ato pavarishtë sektit të cilin ndjekin gjithmonë i orientojnë të gjithë qytetarët kah respektimi i normave të librave të shenjtë të cilët

³⁵ Dr. R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.241-262.

ndalojnë vrasjen, vjedhjen, gënjeshtren dhe udhezojnë që të ndihmohen të paaftit, të varfërit etj. Mirëpo në shumicën e rasteve në mes individëve dhe grupeve të ndryshme për shkakë të besimit tjetër fetar, mostolerancës, kundërthenieve, konflikteve politike, ekstremizmit dhe fanatizmit fetarë, shfrytëzimit të përkatësis, dallimit religjioz shkaktohen konflikte të përgjakëshme, aktivitete teroriste dhe krime tjera të rënda të cilët ndikojnë drejtë për së drejti në etapat e zhillimit të personalitetit, karakterit dhe mentalitetit i llogaritës të tij që përfundimishtë pushton njerzimin dhe egon e tyre.³⁶

Këto faktorë shoqërorë paraqesin një fushë ndërlidhëse magnetike, tërëheqëse që funksionojnë si një tërësi dhe si të tilla ndikojnë fuqishën në brendësinë e qenieve njerzore si në aspektin pozitiv ashtu edhe në aspektin negativ. Si të tilla konsiderohen institucionet sociale të cilat përfshinë familjen, shkollën e posaçërishtë rrethin shoqërorë i cili është burim i një llumi kriminal nga i cili disa sjellje devijante të imponohen krejt natyrshëm dhe më pas ato konvertohen në praktikë rutinore.

Familja si institutë i veçantë dhe si faktorë i rëndësishëm në formimin, edukimin, ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit dhe ngritjen e aftësimin të familjarëve gjegjësishtë te të rinjtë luan një rol të shumëfishtë në formimin e normave morale dhe në parandalimin e përballjes me sjellje devijante. Mirëpo familjet me strukturë jo të plotë familjare siç janë familjet e degraduara dhe deficiente shpeshherë kultivojnë gjurmë negative që më vonë pa aftësimi i tyre për tu përshtatur me mjedisin bartet edhe në institucionet tjera sociale dhe krijohen hapsira për participimin dhe manifestimin e sjelljeve të ndryshme kriminale.³⁷

Faktorët socio-patologjikë paraqesin një sëmundje apo virus shoqërorë që infekton karakterin njerzore duke i shtyrë drejtë akteve imorale që përfaqësojnë një degjenerim të rrezikshëm duke kërcënuar shëndetin e shoqërisë civile. Patologjia shoqërore përfshinë përdorimin e substancave narkotike, lëndët dehëse, lojrat e fatit apo bixhozin, bredhjen dhe lëmshën, prostitucionin, që i gjithë ky dezorganizim shoqërorë që e atribon në masë të konsiderueshme kriminalitetin vjen si pasojë e frekuencës së dobët ekonomike, kulturore, politike që sjellin deri te atakimet e vlerave morale, sociale dhe njerzore.

Përdorimi i substancave të ndryshme narkotike përpos që paraqet problem serioz organik ato gjithashtu paraqesin edhe probeme psiqike të cilat e demargjinalizojnë vetë kontrollin e

³⁶ Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq.222-224, 226-227.

³⁷ <http://juridiksi.e-monsite.com/blog/analiza-dhe-opinione/familja-faktor-me-rendesi-ne-aftesimin-e-personalitetit-kunder-kriminalitetit.html> , parë më:02/07/2019.

njeriut duke e zhytur atë në humnerën që i stenon edhe kontrollin e fuqisë emocionale. Varshmëria nga droga është një sëmundje komplekse dhe kronike e cila vjen si rezultat i ankthit, dëshprimit, mllëfit dhe nga një zinxhir rrethanash tjera që na i servon përditshmëria. Dukuria prostitucion është shumë e përhapur në të ashtuquajturën botë moderne dhe nënkuptonë përmbushjen e epsheve midis dy gjinive të kundërta në shkëmbim të parave ose perfitimeve të tjera materiale ku femra trajtohet si mall për konsum. Zakonishtë kjo dukuri ushtrohet nga femra të cilat vijnë nga shtresat e ulëta shoqërore të cilat dakordohen që të rezikojnë integritetin fizik dhe dinjitetin njerzor, konkretishtë cenojnë vlerat që konsiderohen si të drejta të pacënueshme individuale të njeriut, vetem që të sigurojë kushtet elementare për egzistencën e vetë dhe familjes në përgjithësi.³⁸

Bixhozi është një konceptë i gjërë që përfshinë aktivitete të ndryshme tërëheqëse mvarësishtë nga këndvështrimi perceptualë i njeriut që për disa janë eksperiencia të kënaqëshme, kurse tek të tjerët nxisin efekte negative të cilat çojnë në dëmtim personal, profesional dhe social. Bixhozi zakonishtë fillonë të manifestohet nga mosha e adoleshencës dhe më pas depërton si praktikë rutinore individuale. Të gjithë këto dukuri negative shoqërore të infektuara me sjellje kriminale financohen nga krimi i organizuar i cili dëmtonë dhe rrezikonë në masë të madhe sigurinë shoqërore.³⁹

1.5.2. Faktorët e brendëshëm (subjektivë)

Këto faktorë shkaktojnë e kriminalitetit dhe të sjelljeve devijante i shpjegojnë nëpërmjet neglizhencës së personalitetit të njeriut i cili është i ndërtuar dhe udhëhiqet nga një zinxhirë i bashkëveprimt të rethanave biologjike, psikologjik, sociale dhe individuale të cilat formohen gjatë procesit integruar e perceptues të njeriut në shoqëri në çrast konsekuenca e tyre varet nga familja, shkolla dhe ambienti socialë. Pas studimeve të shumta kriminologjike lidhur me vetitë dhe cilësitë psikike dhe individuale tregojnë se sjelljet potencialishtë të pandërgjegjëshme dhe fanatike vinë nga gjendja emocionale jo stabël, nga temperamentit, shprehitë dhe prirjet, grada e intelegjencës, motivet e ndryshme, bazat psikike, biologjike dhe çregullimet mentale etj. Meqënëse se bota është produktë i vullnetit të njeriut, e pasur nga motoja e madhe që është kulminacioni i “gjithçka është e mundur”, bëri që përfshirja në sjellje kriminale të mos anashkalohet dhe të studjohet burimi i këtij sindromi në variabla të ndryshme nga shumë

³⁸ <http://telegrafi.com>, parë më:06/07/2019.

³⁹ Menada Petro, Lojrat e Fatit, Tiranë 2016, fq.12,14

psikolog, kriminolog, sociolog etj. Edhe pse përballë shpirtit, sekreteve e fuqisë njerzore shkenca është shumë varfanjake, por pavarsishtë kësaj kriminologët konstatojnë se çdo aktivitetë i njeriut normalë është i nxitur nga temperamenti i cili mund të manifestohet me reagimin intensivë të tij ndaj ngacmimeve të jashtme të cilat ngjallin ndjenja të veçanta shpirtërore dhe të fuqishme emocionale jostabile që në situata të tilla individët më lehtë mund të kryejnë sjellje kriminale ose të ndërmarrin veprime në gjendje afekti. Faktorë tjerë të rëndësishëm që shtynë aktivitetin e njeriut në veprim nën vetëdije të plotë dhe me vullnetin e lirë nga forcat e brendëshme janë motivet, të cilat akumulohen nga impenjimet rethore shoqërore, nga ambienti familjarë, agresiviteti, kureshtja dhe nga dëshira për tu klasifikuar me klasat e larta shoqërore.⁴⁰

Një tjetër faktorë i rëndësishëm që ndryshe mund të quhet edhe si aparatë i dominimit të botës dhe ka ndikim të posaçëm në marrjen e vendimit për kryerjen, mënyrën dhe llojin e veprës penale që padysim as nuk i shmanget zotërimit për fshehjen, mbulimin dhe asgjësimin e veprës është intelegjenca. Kur flitet për intelegjencën duhet të kihet parasyshë se pikërishtë kualiteti i saj e bënë dallimin midis njerëzve. Fillimishtë një kohë të gjatë është menduar se numri më i madhë i kriminelëve janë persona me gradë intelegjence më të ulët, mirëpo pas studimeve të shumta kriminologjike dhe të dhënave që dalin nga praktika gjyqësore konstatohet se personat me gradë më të lartë intelegjence dukshëm janë pjesmarës në kryerjen e veprave penale edhe atë te ato të klasifikura si vepra të rënda penale siç janë: krimi i organizuar, trafikimet, vrasjet, vjedhjet e rënda etj.⁴¹

Bazat biologjike janë faktorë që ndërlidhin vetitë anatomike fizike me vetitë dhe cilësitë biologjike të individit me sjelljet kriminale. Në zhvillimin e hulumtimeve dhe në ndriçimin e lidhjeve në mes konstrukcionit trupor të njeriut dhe sjelljes së tij delikuate ka ndikuar dukshëm antropologjia kriminale. Në këtë drejtm Cesaro Lomboso i njohur si babai i kriminologjisë ndaj personave të ndryshëm që janë marrë me sjellje kriminale ka bërë studime, eksperimente dhe hulumtime të shumta mbi persona të gjallë e të vdekur, nëpër spitale, ente ndëshkimore përmirsuese, qendra rehabilituese dhe nëpër burgje të ndryshme ku dhe ai ka ardhur në përfundim se pjesa më e madhe e kriminelëve janë të lindur dhe konstatojnë se këta tipa kanë dukje të veçanta anatomiko fizike që i dallojnë nga jo kriminelet. Personat me nofulla të qitura, me kokë të gjatë e të mprehtë dhe tepër të madhe ose tepër të vogël, me hundë të madhe, me

⁴⁰ David Gadd and Tony Jefferson, *Psychosocial Criminology* 2007, fq. 1-40

⁴¹ Hysi.V, *Kriminologjia*, Tiranë 2005, fq. 238.

veshë të mëdhenjë, me buzë të holla, me ballë të qitur dhe persona që janë të prirur të bëjnë tatuazhe në trupin e tyre, janë të prirur dhe të lindur për tu marrë me sjellje kriminale. Delikuentë potencialë mund të jenë personat me çregullime organike dhe me të meta fizike mirëpo përfshirja e këtyre personave në veprim kriminalë kushtëzohet në masë të madhe nga ambienti shoqërorë, ambienti familjarë, edukata, kujdesi personalë, rethanat ekonomike etj.⁴²

Një kohë të gjatë ka mbretëruar mendimi se kriminaliteti është rezultat i çregullimeve dhe patologjisë sociale. Këto faktorë përfshinë proceset brenda dhe ndër subjektive dhe formimin e identitetit dhe identifikimit në një kuptim më kompleks në lidhjen e subjektit me botën sociale. Individë të sëmurë në pikpamje mentale zakonishtë konsiderohen personat që mbyllen në vetvete sepse bienë ndesh me realitetin, me jetën e përditëshme dhe me botën e vërtetë. Gjendja emocionale e konfliktuar dhe mospërballja me realitetin fizik individin e zhveshë nga konteksti shoqërorë duke e drejtuar atë nga sjelljet devijante e negative. Këto persona trajtohen si delikuentë të veçantë. Të tillë përmenden neurotikët, psikoneuretikët, personat me emocione josatbël, personat egocentrik etj. Ndaj këtyre personave duhet të ndërmeren masa për mbikqyrje, masa për shërim ose të shqiptohen masa preventive siç është vendosja në ente për shërim dhe mbikqyrje të shtuar sepse kur këto persona paraqiten si kryers të veprave penale ato ose nuk i nënshtrohen fare përgjegjësisë penale ose i nënshtrohen vetëm një përgjegjësie të kufizuar.⁴³

⁴² Criminal Man, Cesare Lombroso, Durham and London 2006, fq.1-15

⁴³ Halil.R, Kriminologjia, Prishtinë 2007, fq.362-363.

Kapitulli II

2. Parimet themelore të punës së policisë

Policia është institucion civil i krijuar në bazë të ligjit, konkretishtë autorizimet dhe përgjegjësitë e policisë janë të përcaktuara me Ligjin për Policinë, poashtu në punën e policisë rëndësi të veçantë kanë edhe Kodeksi i Etikës së Policisë dhe Konventat Evropiane mbi Policinë. Policia për të përmbushur aktivitetet që i'a ngarkon ligji gjatë ushtrimit të profesionit zyrtarë , ajo punën dhe detyrat e saj duhet ti udhëheq në bazë të parimeve themelore të cilat janë të përcaktuara me ligj. Kompetencat e policisë janë: mbrojtja e Kushtetutës dhe zbatimi i Ligjit, mbrojtja e jetës, pronës dhe pasurisë të të gjithë qytetarëve pa asnjë dallim race, religjioni, gjinie apo etniteti, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe garantimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve , të identifikojë shkelësit e ligjit etj. Parimet bazë të kriminalistikës dhe etikës policore të cilave policia ju përmbahet gjatë hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kryerësve të tyre janë: Parimi i ligjshmërisë, Parimi i objektivitetit, Parimi i proporcionalitetit, Parimi i efikasitetit dhe Parimi i profesionalitetit.⁴⁴

Funksioni parësorë i Policisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është të mbrojë dhe respektojë liritë dhe të drejtat themelore, të drejtat njerëzore dhe civile të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara, mbrojtjen e rendit ligjor, parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme, marrjen e masave për ndjekjen e kryerësve të veprave të tilla, dhe ruajtjen e rendit publik dhe paqen në shoqëri.⁴⁵

Duke u bazuar në ligjin e policisë së Republikës së Maqedonisë veprimet ose parimet udhëzuese që ju referohen nëpunësve policorë janë:

- Mbrojtja e jetës, siguria personale dhe pasuria e qytetarëve;
- Mbrojtja e lirive dhe e të drejtave të individit dhe qytetarit të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë; ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- Parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre dhe marrjen e masave të tjera të përcaktuara me ligj për të ndjekur penalisht kryerësit e këtyre veprimeve;

⁴⁴ Fatos Haziri, E DREJTA POLICORE, Prishtinë 2010, fq. 59-60.

⁴⁵ ЗАКОН ЗА ПОЛИЦИЈА „Службен весник на Република Македонија“ бр.114/06, ч.л 3.

- Identifikimin dhe kërkimin e pasurisë së drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të fituar me veprë penale;
- Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike;
- Rregullimin dhe kontrollin e trafikut rrugor;
- Kontrollin e lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve;
- Kontrollet kufitare dhe mbikëqyrjen kufitare;
- Sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes për qytetarët në rast nevoje;
- Sigurimin e personave dhe pajisjeve të caktuara dhe
- Aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj.⁴⁶

2.1. Parimi i ligjshmërisë në punën e policisë

Parimi i ligjshmërisë është një ndër parimet themelore të çdo funksioni të organeve shtetërore të ndryshme e sidomos kur flasim për ushtrimin e funksionit të detyrës policore. Parimi i ligjshmërisë nënkupton çdo aktivitet që ka për qëllim kundërvënien ndaj kriminalitetit duke ju përmbajtur me përpikshmëri shumë të lartë dispozitave ligjore. Parimi i ligjshmërisë kërkon respektimin e domosdoshëm, të përpiktë dhe të pakompromis të ligjeve, akteve nënligjore, rregullave, urdhëresave si dhe të gjitha akteve të tjera të cilat parashtrohen nga çdo lloj organi tjetër shtetërorë. Për të arritur kulminacionin e suksesit në realizimin e qëllimeve kriminogjene gjatë ushtrimit të detyrave policore, e sidomos kur kanë të bëjnë me parandalimin ose prevencionin e ndonjë krimi të organizuar nga një individë ose grup njerëzish, policia është e detyruar të veproj në harmonizim, kordinim dhe mbi të gjitha funksioni i tyre duhet të ketë ndërlidhshmëri reciproke që respektimi i parimit të ligjshmërisë të arrijë maksimalen. Nëse gjatë ushtrimit të funksionit të vetë nënpunsit policorë ose policia si tërësi institucionale i nënshtrohet korrupsionit, ndikimeve politike etj, atëherë funksionaliteti i policisë deformohet dhe shkakton dëm të konsiderueshëm të sistemit juridik, institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve tjera në tërësi. Papërgjegjëshmëria e organeve të jurispodencës kontribuon në pasigurinë e përgjithshme juridike, forcon tendencat kriminale, dobëson orientimet morale dhe besueshmërinë, rrit pasigurinë e shoqërisë dhe forcon kriminalitetin.⁴⁷

⁴⁶ ЗАКОН ЗА ПОЛИЦИЈА „ Службен весник на Република Македонија“ бр.114/06, ч.л 5.

⁴⁷ Parandalimi i Kriminalitetiti, Elmedin Muratbegović, Sarajevë/Prishtinë, Prill 2007, fq.16-18.

2.2. Parimi i objektivitetit në punën e policisë

Ky është një ndër parimet themelore dhe parakushtë për arritjen e së vërtetës të ndonjë vepre të caktuar penale. Me këtë parim lehtësisht bëhet zbulimi i një të vërtete por që paraqet një proces të ndërlikuar deri tek arritja e saj. Parimi i objektivitetit domosdoshmërishtë duhet të jetë i pranishëm në funksionimin e një nëpunësi policorë kur është fjala për verifikimin e së vërtetës materiale qoftë kur është fjala për vepren penale , qoftë kur bëhet fjalë për kryersin e saj. Me ndihmën e arritjes së të vërtetës nëpunësi duhet të tejkalojë karakterin subjektiv të pikpamjeve të veta që do me thënë që punën e vetë ta kryejë pa paragjykime, qëndrime të një anëshme dhe të ndikuar nga dobia materiale ose motive tjera të ngjajshme që lidhen me interesin personal. Ato duhet ta zhvillojnë në unin e vetë idenë e pa luhatëshme për të vërtetën dhe drejtësinë. Nuk tolerohet që objektivës ti jepet mundësia që një rast penal ta zgjedhë në mënyrë të shpejtë dhe sipas dëshirave të veta pa pasur parasyshtë grumbullimin e fakteve dhe provave të caktuara me të cilat mund të ngarkohet i dyshuari apo i akuzuari. Objektivës nuk i lejohet qëndrimi sipas tekave, dëshirave dhe ndikimeve tjera personale qofshin të jashtme apo të brendëshme , sepse qëndrimet e tilla janë shumë të dëmshme dhe paraqesin rrezikshmëri dhe shkaktojnë dëm të koniderueshëm kur nëpunësi policorë mund të ketë arsytim të caktuar personal. Grumbullimi i fakteve, njoftimve, dhe provave tjera të mundëshme nga nëpunësi policorë duhet të shihen nga aspekti i tyre real, nuk duhet as të mbivlerësohen. Objektiviteti për aritjen e një të vërtete paraprakishtë duhet të përcaktojë masa përkatëse, operative, taktike dhe gjithmonë duhet ti orientojë sipas planit të paracaktuar operativ dhe nevojave reale, gjithashtu duhet të theksohet se aspekti objektiv i veprimit kërkonë shqyrtim të përhershëm të sjelljes personale duke anashkaluar çfardo lloj simpatie apo antipatie të kryersit të ndonjë vepre penale. Respektimi i parimit të objektiviteti lidhet ngushtë dhe drejtë për së drejti me profesionalizimin, kualifikimet, motivimin dhe me standardet e larta profesionale që duhet ti ketë çdo nëpunës policorë.⁴⁸

⁴⁸ Goce Xhukleski, Muhamet Racaj, Hyrje në kriminalistikë, Shkup 2012, fq. 55-56.

2.3. Parimi i efikasitetit në punën e policisë

Parimi i efikasitetit është parimi shumë i rëndësishëm në punën e policisë i cili paraqet një raport optimal në mes detyrave të parashtruara dhe rezultateve të arritura. Edhe pse efikasiteti është kërkesë e vazhdueshme e shoqërisë egzistojnë shumë faktorë të tjerë që ndikojnë direkt në shkallën e efikasitetit të policisë siç janë organizimi funksional, profesionalizmi, taktikat, teknikat, metodikat etj.⁴⁹

Parimi i efikasitetit është parim i cili nuk funksionon në shprazëtirë. Për një shërbim policorë mund të themi se është efektiv kur ai është në gjendje që të kryej funksionet dhe rolet kryesore për të përmbushur qëllimet e caktuara të saj. Për një shërbim policorë mund të themi se është eficient atëherë kur në maksimum i shfrytëzon të gjitha burimet nga të cilat realizohet shërbimi siç janë koha, buxheti, resurset njerzore dhe materiale të cilat atakohen në mënyrë optimale për kryerjen e funksioneve që shërbimi policorë të arrijë pikë synimet e caktuara. Sektorët e policisë dhe zyrtarët e sajë në përgjithësi duhet të jenë të përgaditur për të garantuar mosçenimin e të gjitha parimeve tjera kyçe të policimit demokratik apo modern, gjithashtu duhet të kujdesen që të garantohet integriteti, sundimi i ligjit dhe llogaridhënia.⁵⁰

2.4. Parimi i proporcionalitetit në punën e policisë

Parimi i proporcionalitetit është shumë i rëndësishëm në punën e policisë e sidomos kur meren masat për zbatimin ose aplikimin e këtij parimi duhet të kenë në konsideratë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut duke shqyrtuar apo analizuar përdorimin e forcës të cilën mund ta ushtrojë policia ndaj individit të dyshuar për shkeljen e dispozitave ligjore dhe të drejtave të një shteti, përdorimi i forcës në raste të tilla duhet të jetë i arsyeshme. Parimi i proporcionalitetit gjithashtu kërkon preventivën ndaj masave dhe veprimeve tjera të përcaktuara me ligj, gjithmonë duke pasur kujdes mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e policisë.⁵¹

Ky parim obligon nëpunësit policorë që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo ushtrimit të profesionit të ndërmarin vetem ato masa, mjete dhe metoda të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimit ligjorë, pikërishtë ushtrimi i dhunës ndaj delikuentit apo qytetarit i cili mund të kryej

⁴⁹ Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997, fq. 105.

⁵⁰ Arjan Dymishi, Manual Trajtimi për Integritetin e Policisë, Tiranë 2016, fq. 42.

⁵¹ Fatos Haziri, E Drejta Policore, Prishtinë 2010, fq. 63.

ndonjë vepër penale të natyrave të ndryshme është e përcaktuar me ligj të posaçëm dhe mund të përdoret vetëm kur përmbushen kriteret për aplikimin e dhunës dhe detyrimishtë ky parim kërkon që intensiteti i përdorimit të saj të jetë i kontrolluar dhe i limituar deri në maksimumin e mundshëm me qëllimë që aplikimi i saj të mos shkaktojë dhimbje përtej të nevojshmes. Sipas parimit të proporcionalitetit ushtrimi i dhunës apo përdorimi i forcës jashtë masave ose regullave tjera të përcaktuara me ligj lejohet vetëm në raste të jashtëzakonëshme siç mund të jenë protestat apo tubimet e ndryshme nga të cilat mund të eskaloj situata nga ana e qytetarëve duke cënuar institucionet publike apo integritetin e personave fizikë, atëherë policia mund të përdorë dhunë apo forcë për parandalimin e këtij konflikti. Megjithatë përsëri dhuna e ushtruar nga ana e policisë duhet të jetë në ata përmasa siç e parashehë ligji apo regullativat tjera ndërkombëtare, por në qoftë se ndodh një gjë e tillë që të shkelet ligji atëherë policia duhet tu nënshtrohet komisioneve të posaçme (inspektoriatit) të cilat konstatojnë tejkalimin e përdorimit të forcës nga ana e policisë. Nëse konstatohet se janë shkelur normat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe regullativat tjera të shkruara atëherë policia duhet të sanksionohet konform ligjit.⁵²

2.5. Parimi i humanitetit në punën e policisë

Parimi i humanitetit është parim shumë i rëndësishëm sepse nuk është vetëm parim i natyrës operative kriminalistike por ky parim ka të bëjë edhe me veprimet dhe sjelljet e çdo polici kur vijnë në shprehje personaliteti i njeriut. Humaniteti është imperativë në punën e masave hetimore kriminale dhe si i tillë ndikon pozitivisht në moralin dhe sjelljen e njerëzve e sidomos ndaj kryesve të veprave penale. Duke u nisur nga fakti se dinjiteti, integriteti psikik, fizik dhe shëndeti janë vlera të pa cënueshme të njeriut, parimi i humanitetit në këtë konotacion kërkon që mënyra e veprimit ndaj të dyshuarit, të akuzuarit dhe të gjykuarit mos i rrezikojë këto vlera. Parimi i humanitetit në kuadër të politikës së luftimit të kriminalitetit, konkretisht gjatë aplikimit të dhunës dhe masave represive ka për qëllim eliminimin e dhunës në tërësi. Në qoftë se eliminimi i tërësishëm i kësaj dukurie nuk mund të arrihet, të paktën parimi human e kufizon atë deri në maksimumin e mundshëm. Parimi i humanitetit ka karakter të dyfishtë kur janë në pyetje masat preventive në luftimin e kriminalitetit. Është fakt se kriminaliteti paraqet sulm agresivë që degradon vlerat njerëzore,

⁵² Qebir Avziu, Hyrje në Kriminalistikë, fq. 79-81.

megjithatë ky fakt nuk e arsyetonë aplikimin e dhunës pavarësisht shkallës së agresivitetit sepse me aplikimin e masave represive gjatë luftimit të kriminalitetit legjislacioni dhe kushtetuta lejon forma të tjera të kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.⁵³

2.6. Parimi i shpejtësisë dhe i befasisë në punën e policisë

Duke u nisur nga fakti se koha mund të jetë aleat më i mirë, konkludojmë se sa më e shkurtër të jetë distanca kohore ndërmjet kryerjes dhe zbulimit të aktit përkatës, aq më të mëdha janë gjasat për sukses. Shpejtësia dhe befasia zënë vend të rëndësishëm në zbardhjen e veprës penale.⁵⁴ Veprimet dhe masat e shpejta kriminalistike e befasojnë fajtorin duke mos i lënë hapsirë të kryej veprën penale ose ti shmanget fajit për veprën e kryer. Ky parim kërkon qetësi, urtësi, energji dhe reagim të shpejtë dhe të drejtëpërdrejtë kundër fenomeneve të cilat në vetë ngërthejnë elemente të veprës penale dhe të veprave të tjera të ngjajshme. Gjatë veprimit të shpejtë për të kapur fajtorin në flagrancë, veprimi apo puna e policisë duhet të jetë dinamike dhe elastike sepse këto janë elemente bazë për të arritur garancion në sukses. Shpejtësia dhe operativiteti janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën si metoda bashkëveprimi të punës jashtë hapsirave zyrtare, madje ekzekutuesit apo kriminalistët duhet të jenë në kontakte të ngushta dhe në bashkëpunim të mirfilltë me qytetarët në teren. Nuk duhet të neglizhohet edhe fakti se kohë pas kohe, koha punon edhe për kryerjen e veprës penale, prandaj është shumë e rëndësishme ndërmarja e masave të parakohëshme për ta eliminuar tërësinë e masave, elementeve, dhe veprimeve kriminale.⁵⁵

2.7 Parimi i kordinimit dhe i bashkëpunimit në punën e policisë

Kur bëhet fjalë për luftën ndaj kriminalitetit nëpunësit e policisë duhet të kenë parasyshë maksimumin e kordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstucional për të patur suksesin e duhur në luftë kundër kriminalitetit, kjo do të thotë se sukcesi arrihet me pjesëmarrjen dhe angazhimin e njëkohësishëm të të gjithë atyre që mund të kontribuojnë në këtë fushë.

⁵³ Haris Halilović, Politika e luftimit të kriminalitetit, fq. 56

⁵⁴ Xhukuleski.G, Racaj.M, Hyrje në kriminalistikë, Shkup 2012, fq. 52-54.

⁵⁵ Latifi Vesel, Kriminalistika, Prishtinë 2011, fq. 23-24.

Duke pasur parasyshë se jetojmë në kohën ku infrastruktura rrugore, ajrore dhe detare janë të zhvilluara dihet se edhe kriminaliteti nuk është i kufizuar vetëm në një vend apo hapsirë rajonale, por veprat penale janë dukuri që krijohen dhe zhvillohen si në hapësira të vogla lokale, rajonale, interlokale dhe globale apo ndërkombëtare. Në këtë rastë lufta kundër kriminalitetit kërkonë kordinim dhe bashkpunim ndërkombëtarë midis qendrave policore .⁵⁶

⁵⁶ Vesel Latifi, Kriminalisika, Prishtinë 2011, fq 25.

Kapitulli III

3. VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË, JETËS DHE TRUPIT, QARKULLIMIT PAGESORË DHE EKONOMISË

3.1. Larja e parave në Republikën e Maqedonisë nga viti 2013-2018

Larja e parave është procesi i fshehjes së burimeve ilegale të të hyrave të cilat realizohen nëpërmjet veprave penale, me qëllim të futjes së këtyre të ardhurave në rrjedhat e afarizmit legal financiar. Termi larje e parave nënkupton fitimin, posedimin, këmbimin, shfrytësimin, procesin dhe bartjen e pasurisë të realizuar me aktivitete kriminale dhe mjete ilegale të kundërligjshme dhe shëndrimin e këtyre mjeteve në pasuri me prejardhje legale. Sipas ligjit mbi parandalimin e larjes së parave, larja e parave nënkupton fshehjen e natyrës së vërtetë, vendit, prejardhjes, qarkullimit dhe të drejtës mbi pronën në qoftë se kjo pronë është krijuar me veprime kriminale, me pjesmarje në veprime të tilla, nxitje, me dhënien e ndihmes, bashkpunimit etj.⁵⁷

Ky krim ekonomik i cili është domosdoshmëri e krimit të organizuar përbënë një rrezik serioz dhe destabilizues për ekonominë si në të gjitha vendet ashtu edhe në vendin tonë sepse pastrimi i parave gjeneron shuma të mëdha parash të cilat janë vështirë të maten dhe këto mjetet monetare shfrytëzohen për shpenzimin e aktiviteteve tjera kriminale, për të korruptuar zyrtarët e ndyshëm, për ti shpëtuar ndjekjes dhe të tjera. E vetmja provë ligjore për të akuzuar për veprën penale të pastrimit të parave është kalimi i produkteve të krimit në dorë të personave, mirëpo autorët e veprave penale për tu shmangur nga inkriminimi dhe për ti ruajtur të ardhurat e fitura nga këto aktivitete ato duhet ti fshehin, maskojnë apo tjetërsojnë pasuritë duke i regjistruar në emër të personave të tjerë me qëllim që të duken si të ligjshme sepse hyrja e tyre në sisteme bankare është i vetmi sistem i vlefshëm.⁵⁸ Pra kjo vepër penale realizohet nëpërmjet këtyre veprimeve: Depozitimit, tjetërsimit, transferimit ose këmbimit të parave me qëllim të maskimit, fshehjes ose mohimit të përkatësisë apo origjinës së pasurisë që rrjedhë nga veprimtaria kriminale, Fitimit të së drejtës së pronësisë mbi çdo lloj pasurie, që rrjedh nga veprimtaria kriminale apo nëpërmjet përdorimit të parave të papastra kur subjekti ka njohuri, dhe

⁵⁷ Dr. Mirsad Suçeska, BAZAT E KRIMINALITETIT EKONOMIK, Prishtinë 2006, fq155,156.

⁵⁸ <http://telegraf.al/i-pakategorizuar/dr-naim-mecalla-krimi-i-organizuar-dhe-pastrimi-i-parave/>
më:20.07.2019

Ndërmjetësimit në favor të një personi tjetër për depozitimin, tjetësimin, transferimin dhe këmbimin e mjeteve monetare me qëllim të maskimit, fshehjes së përkatësis ose origjinës.⁵⁹

Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë për veprën penale “Larja e Parave” në Nenin 273 në paragrafin 1, 3, 5, 6 janë paraparë këto dënime: (1) Ai person që fut në qarkullim ose qarkullon, pranon, merr përsipër zëvendësimin ose konfiskimin e parave ose pasurive të tjera që ai i ka fituar me vepër penale ose dihet që janë fituar nga një vepër penale, ose nga konvertimi, ndryshimi, transferimi ose fshehja e origjinës së tij ose saj nga një burim i tillë ose fshehja e vendndodhjes, lëvizjes ose pronësisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet. (3) Nëse vepra penale nga paragrafët (1) është kryer në veprimtari bankare, financiare ose biznes tjetër ose nëse me prishjen e transaksionit ka shmangur detyrimin për të raportuar në rastet e parashikuara me ligj, kryesi dënohet me burgim së paku tre vjet, (5) Një person që kryen krimin e përmendur në paragrafët 1 dhe 3 si anëtarë i një grupi ose një shoqate tjetër të angazhuar në pastrim parash, marrje të paligjshme të pasurisë ose të ardhurave të tjera të krimit, ose me ndihmën e bankave të huaja, institucioneve financiare ose personave, dënohet me burgim të paktën pesë vjet, (6) Një person Zyrtar, përgjegjës bankar, kompani sigurimesh, një kompani e angazhuar në organizimin e lojërave të fatit, një zyrë shkëmbimi, një bursë ose një institucion tjetër financiar, një avokat, përveç kur vepron si avokat, noter publik ose person tjetër që kryen autorizime publike ose çështje me interes publik, i cili do të mundësojë ose lejojë një transaksion ose marrëdhënie biznesi, në kundërshtim me detyrën e tij ligjore ose do të kryejë një transaksion në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga një autoritet kompetentë ose një masë e përkohëshme e urdhëruar nga një gjykatë ose mos raportimi i pastrimit të parave, pronave ose pasurive për të cilat ka mësuar në kryerjen e funksionit ose detyrës së tij, dënohet me burgim të paktën pesë vjet.⁶⁰

Kjo dukuri është e pranishme në të gjitha shtetet e botës, por në mënyrë të veçantë ajo gjenë hapsira të përshtatëshme dhe dëmton më shumë shtetet që janë të dobëta ekonomikisht, shtetet në tranzicion dhe shtetet me probleme sociale-politike dhe pa stabilitet, andaj rreziku që paraqet për vendin tonë ky lloj kriminaliteti është i madh për shkak të pasojave të rënda që sjell dhe kërkon jo vetëm vlerësimin e tij nga ana e shtetit por edhe organizimin institucional veçanërisht nga Njësia e Intelgjencës Financiare për kundërvënje me efektivitet me qëllim të ruajtjes dhe sigurimit të ekonomisë legale nga investimet e karakterit kriminal, gjithashtu

⁵⁹ Korrupsioni, Luan Gjonca, Tiranë 2004, fq 193

⁶⁰ КРИВИЧЕН ЗАКОНИК на Р.Македонија, Член 273, став 1,3,5,6.

kërkon shkatërrimin e bazave ekonomike duke ju konfisuar mjetet monetare të fituara me veprë penale dhe duke i identifikuar, gjurmuar, fiksuar nga bashkëpunorët më të vegjël deri tek liderët kryesorë të bashkësive dhe organizatave të krimit të organizuar.⁶¹

Maqedonia është palë nënshkruese e Konventës së Këshillit të Europës mbi Shpërlarjen, Kërkimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (1990), Konventës mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (1959), ndërsa në vitin 2001 miratoi ligjin për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe të Ardhurave tjera nga Krimi i cili u bë operacional në vitin 2002 dhe krijoi Njësinë Kombëtare Financiare Analitike në kuadër të Ministrisë së Financave, kurse në v.2003 Kuvendi i Maqedonisë miratoi ligjin nëpërmjet të cilit do të garantohej mbikqyrja e transaksioneve të parave nga Banka Kombëtare.⁶²

Nëpërmjet tabelës 1 do të paraqesim raportimin e përgjithshëm të “Larjes së Parave” në Republikën e Maqedonisë të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendëshme.

Tabela 1.

Numri i përgjithshëm i veprave penale të Larjes së Parave në R.Maqedonisë						
	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Vepra penale	12	6	7	4	6	20
Kryers	45	30	24	32	17	23
Gjithësej ka pasur 55 raste të Larjes së Parave						

Në këtë tabelë vërejmë numrin për rastet e Larjes së Parave në të gjithë teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ku sipas të dhënave statistikore gjatë vitit 2013 janë raportuar 45 persona dhe 12 vepra, në vitin 2014 janë raportuar 30 persona dhe 6 vepra penale, në 2015 janë raportuar 24 persona dhe 7 vepra, në 2016 kryers 32 dhe 4 vepra, në 2017 vepra 6 dhe 17 kryers dhe në 2018 janë raportuar 20 vepra dhe 23 kryers, ku gjithësej brenda periudhes kohore 6 vjeçare janë raportuar 55 raste të larjes së parave kurse numri i përgjithshëm i personave që janë raportuar është 171.⁶³

⁶¹ http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/pastrimi-i-parava-te-pista.html?fbclid=IwAR3B8hqIkmvYoYk9n6djAeg4svFz04i5yd_c5MGgzvpUImt0ZPUDFRPpQ7k parë më:22.07.2019

⁶² Tamara Brnetic, Money laundering best practices, lessons to be learnt and steps to be taken in the balkan region. By a thesis presented in partial completion of the requirements of “The certificate of Training in United Nation Peace Support Operations”, fq.38.

⁶³ Të dhëna të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendëshme, në datën 29.07.2019

Nëpërmjet tabelës numër 2 do të paraqesim të dhëna statistikore nga viti 2013 deri në vitin 2018, të siguruara nga Stacioni Policor i Tetovës dhe Gostivarit për rastet e larjes së parave dhe pjesmarrsit në këto vepra në të dy qytetet. Në tabelën që do të paraqes më poshtë do vërehet se në Komunën e Tetovës nga viti 2013 deri ne vitin 2018 nuk është raportuar asnjë rast i larjes së parave e asnjë pjesmarës, gjithashtu edhe në Komunën e Gostivarit nga viti 2013 deri ne vitin 2017 nuk është raportuar as person as rast për këtë vepër penale, kurse vepra penale te këtij lloji janë raportuar vetëm ne vitin 2018 ku figurojnë 9 vepra dhe 9 kryers. Sipas raprtit statistikorë konstatohet se Komuna e Tetovës nuk është rrezikuar nga ky lloj krimi ekonomik kurse Kumuna e Gostivarit ka filluar të preket nga rrezikshmëria e këtij fenomeni në vitin e fundit 2018.⁶⁴

Tabela 2.

	2013		2014		2015		2016		2017		2018	
	Vepra	Kryers	Vepra	Kryers	Vepra	Kryers	Vepra	Kryers	Vepra	Kryers	Vepra	Kryers
Tetovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gostivar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9	9

Rast konkret:

K.J. është ndaluar nga policia maqedonase si e dyshuar për rastin “Reket”, ka bërë të ditur Prokurori Publik, Lubomir Jovevski. Organi i akuzës kërkon masën e paraburgimit për K.J. e cila në mesditë u shoqërua në stacion policor nga forca të shumta policore. Prokurori Jovevski tha se K.J. dyshohet të ketë shpërdorur detyrën zyrtare në skandalin e zhvatjes së 1.5 milion euro të një afaristi, nga dy persona të afërt me kreun e speciale. B.J. dhe Z.M. dy personat që shihen në incizim duke marrë paratë, i premtojnë afarstit, O.K. se në bashkëpunim me K.J. do t’i lehtësojnë atij procesin gjyqësor në një aferë tjetër korruptive. Ky skandal ka shkaktuar përplasje të shumta mes partive politike për atë nëse ka ose jo të përfshirë edhe politikanë.⁶⁵

Nga të gjithë statistikat e raportuara shihet qartë se aktualishtë Republika e Maqedonisë me gjendjen ekonomike që posedon rangohet në vendet e varfëra që janë në proces tranzicioni, dhe padyshim se përveç larjes së parave Maqedonia është edhe frekuencë e veprave të ndryshme

⁶⁴ Të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendëshme të siguruara nga Stacioni Policorë i Tetovës dhe Gostivarit, në datën 29.07.2019

⁶⁵ <https://balkanweb.com/kerkohet-paraburgim-per-prokuroren-speciale-te-maqedonise-veriore/> ,parë më:30.07.2019

me karakter kriminal të cilat dëmtojnë interesat publike në këmbim të interesave private. Pikërisht në Maqedoni larja e parave shfaq një fenomen shumë negativ sepse varion me pasoja të mëdha ekonomike, sociale, politike, dhe kërkon një strategji specifike ndërinstucionale mirë të organizuar nga politika dhe pushteti për një luftim sa më efektiv të kësaj dukurie, mirëpo ato që efektivitetin e kahëzojnë kah defektivitetin në vendin tonë janë prapaskenat e këtij krimi që fshehin “SHIFRA TË ERRËTA” dhe “KRIMINEL TË JAKAVE TË BARDHA”. Gjithësesi edhe pse numri statistikor për rastet e larjes së parave nuk raportohet i saktë Maqedonia dukshëm është e kërcënuar nga ky lloj krimi ekonomik, mirëpo ajo që i jep fuqinë si shtet Maqedonisë është se nuk posedon mungesë të kornizës ligjore për ta luftuar, penguar, parandaluar dhe për ta dënuar këtë veprë penale, por problematika qëndron në mos zbatimin e kësaj kornize ligjore fillimisht nga vetë elita e institucioneve shtetërore e më pas nga grupe të caktuar njerëzish që pretendojnë të zgjohen të pasur.

3.2. Trafikimi i substancave narkotike ne Komunën e Tetovës

Trafikimi i substancave narkotike është një ndër format më të shpeshta të krimit të organizuar. Kontrabanda me narkotikë me organizimin dhe konspirativitetin e saj mban vendin e parë në fushën e kriminalitetit profesional që rezikon të gjithë vendet e botës. Tregtia e palejuar e drogave dhe përdorimi i substancave narkotike vinë si rezultat i krizës ekonomike, varfërisë, papunësis, dëshirës për pasurim të shpejtë, çregullimeve familjare, konflikteve politike, pra të të gjithë këto janë faktorë të drejtëpërdrejtë që individin e zhveshin nga konteksti i tij shoqëror duke i rritur tendencën antisociale.⁶⁶

Trafikimi i substancave të ndryshme narkotike ose drogave kryhet nga persona me prirje kriminale, të cilët janë të organizuar në grupe dhe organizata të regjistruara në menyrë legale për të pasur mbulesë para organeve të pushtetit, policisë dhe administratës. Aktivitetet kriminale i kanë të maskuara me një organizim me strukturë organizative mjaft të zgjruar dhe të përsosur. Dëshira për të arritur fitime të mëdha nëpërmjet tregtisë ilegale të substancave të ndryshme narkotike ose drogave, shumë persona dhe organizata kriminale i motivon që të merren me këtë veprimtari kriminale. Ky lloj kriminaliteti kryhet me futjen ose nxjerrjen fshehurazi të lëndëve narkotike të ndaluara e të paligjshme, veprim që në të gjitha shtetet paraqet veprë penale, për të cilat janë paraparë denime shumë të renda. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë drogat

⁶⁶ Latifi Vesel, Kriminalistika, Prishtinë 2011, fq 290,292.

i klasifikojmë në tre grupe: **Stimulantet** janë droga eksituese dhe përfshihet kokaina, atropina, amfetamina, kafeina, teina, nikotina, **Halucinogjenet** janë droga që shfaqin iluzione dhe përfshihen kanabisi (hashishi, mariuhana), **Depresantet** janë droga që kanë efekt qetësues dhe përfshihen opiumi, morfina, heroina.⁶⁷

Në Maqedoni tregtia e drogës u bë shumë shpejtë element thelbësorë i rjeteve të kontrabandës ku pjesa më e madhe e heroinës transportohet nga Turqia në Europën Perëndimore përmes Maqedonisë. Mirëpo shumica e mallrave që transportohen deklarohen se vetëm do të kalohen nëpër Maqedoni, kurse në të vërtetë ato mbeten në vend dhe shiten pa u paguar taksat dhe detyrimet. Përveç që është një rrugë tranzitore, gjithashtu Maqedonia u shndërrua edhe si vend i rëndësishëm i prodhimit të drogës pasi industria kimike humbi të gjitha tregjet e saj të mëparshme dhe për t'u shmangur falimentimit ajo prodhoi kimikate pararendëse të cilat i transportoi në Turqi ku u përdorën për prodhimin e heroinës. Situata e rëndë ekonomike në Republikën e Maqedonisë ka detyruar që një numër i konsiderueshëm i popullsisë të kyçen në tregun e zi dhe të meren me tregti të paligjshme.⁶⁸

Në vazhdim do të paraqesim tabelën 1 dhe 2 me të dhëna statistikore të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i Punëve të Brendshme Tetovë dhe Gostivarë, me anë të së cilave do të pasqyrojmë prezencën dhe shkallën e rrezikshmërisë së këtij fenomeni në vendin tonë në nivel republikan kurse në tabelën 2 do të bëjmë një krahasim midis qytetit të Tetovës dhe Gostivarit.⁶⁹

Tabela 1.

Statistat e Trafikimit të Substacave Narkotike në R. Maqedonisë						
Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Vepra penale	412	577	515	488	464	673
Kryerës	514	714	615	572	532	782

⁶⁷ E. Alketa, Droga një sfidë intelektuale, aspektet penalo-juridike dhe krahasime të saj, Tiranë 2012, fq.109-110, 18.

⁶⁸ Marko Hajdinjak, Smuggling in SouthEast Europe, The Yugoslav Wars and the Development of Regional Criminal Networks in the Balkans, Center for the study of democracy 2002, fq 29-30.

⁶⁹ Të dhëna të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i Punëve të Brendshme Tetovë dhe Gostivarë, Tabela1 dhe Tabela 2, në datën 29.07.2019.

Tabela 2

	2013		2014		2015		2016		2017		2018	
	Vepra	Kryerës	Vepra	Kryerës	Vepra	Kryerës	Vepra	Kryerës	Vepra	Kryerës	Vepra	Kryerës
Tetovës	20	29	76	129	29	35	31	40	25	25	90	100
Gostivar	16	18	24	27	42	50	30	36	27	33	45	55

Shikuar nga numri i raportuar në nivel republikan në tabelën 1 vërejmë se ky lloj krimi me karakter profitabil ka depërtuar në të gjitha segmentet në vendin tonë që në bazë të statistikave vërehet një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish dhe transportesh me substanca narkotike të llojeve të ndryshme, ku brenda 6 viteve të fundit nga viti 2013 deri në vitin 2018 gjithësej ka pasur 3129 vepra penale të këtij llojit kurse si pjesëmarrës janë raportuar 3729 persona. Vështruar nga aspekti i masave për parandalimin e këtij fenomeni nga organet shtetërore, efektiviteti shihet qartë sidomos në vitin 2018 ku numri i veprave penale dhe pjesëmarrësve në veprën e këtij lloji ka pësuar rritje. Në tabelën numër dy vërejmë se në Tetovë nga viti 2013 deri në 2018 numri i transporteve figuron në 271 me 358 pjesëmarrës, kurse në qytetin e Gostivarit nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë raportuar 184 vepra dhe 219 kryerës. Në të gjithë Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas raportit të Ministris për Punë të Brendshme numri i trafikimeve me substanca të ndryshme narkotike për 6 vite figuron 3129 dhe 3729 pjesëmarrës, ku nga numri i përgjithshëm 455 vepra janë kryer në Tetovë dhe Gostivarë nga 577 persona.

Trafikimi i substancave të ndryshme narkotike në Republikën e Maqedonisë së Veriut rangohet tek veprat e rënda penale dhe dënohet me Nenin 215 dhe 216 të Kodit Penal të R.M.V. Sipas KPM-së në Nenin 215 në paragrafin (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) parashihen këto dënime: (1) Një person që prodhon, përpunon, shet ose ofron ofertë të paautorizuar, blen, mban ose transferon ose shet ose blen ose përndryshe e paautorizon shitjen e narkotikëve, substancave psikotrope dhe pararendësve, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. (2) Nëse krimi nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer me lëndë narkotike droga, substancat psikotrope dhe pararendësit e një sasi më të vogël, kryesi dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. (3) Nëse vepra penale nga pika 1 është kryer nga disa persona ose kryesi i këtij krimi ka organizuar një rrjet shitësish ose ndërmjetës, kryesi dënohet me burgim më së paku pesë vjet. (4) Personi që paautorizon, bën prokuron, ndërmjetëson ose jep përdorimin e pajisjeve, materialit ose substancave që dihet se përdoren për prodhimin e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe pararendësve do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. (5) Shkelësi nga paragrafi 2, me përjashtim të organizatorit, i cili do të zbulojë veprën ose të kontribuojë në zbulimin e saj, do të lirohet. (6) Nëse vepra penale nga ky nen është kryer nga një person juridik,

dënohet me gjobë. (7) Droga narkotike, substancat psikotrope dhe pararendësit, si dhe pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme të përdorura për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e tyre, konfiskohen, kurse në Nenin 216 në paragrafin (1) përcaktohet se Një person i cili e shtyn një tjetër të shijojë drogat narkotike dhe pararendësit ose i jep ilaçe narkotike dhe substanca psikotrope për ta shijuar ai person ose personi tjetër ose do të vërë në dispozicion ambiente për shijimin e drogave narkotike, substancave psikotrope ose përndryshe lejon një person tjetër të shijojë , substanca psikotrope, do të dënohet me një deri në pesë vjet burg. (2) Nëse krimi nga pika 1 është kryer kundër një të mituri ose kundër më shumë personave ose janë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, kryesi dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.⁷⁰

Rast konkret:

Në një shtëpi në Tetovë është gjetur laboratorin më i madh në Ballkan për shitje të drogës sintetike. Gjatë aksionit të realizuar gjatë natës së mbrëmshme është konfiskuar mbi 125 kilogram drogë dhe tableta në vlerë prej 2.5 milion euro. Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski njoftoi se si pasojë e këtij aksioni janë arrestuar gjashtë persona, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

“Dua që të ju informoj se Departamenti kundër Krimit Të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Prokurori i Prokurorisë Themelore Publike për krim të organizuar dhe korrupsion me një ekip të përbashkët hetues të Republikës së Serbisë dhe me aktivitete të kordinuara të DEA-s, Zyra për Luftë kundër Drogës të SHBA-ve, kanë realizuar një hetim ndërkombëtar kriminalistik, me qëllim zbulimin e një grupi të organizuar kriminal, e përfshirë në shitje të pligjshme të drogave”, ka deklaruar Spasovski. Ministri Spasovski bëri të ditur se në bazë të hetimeve të deritanishme bëhet fjalë për gjetje të sasisë më të madhe të drogës sintetike në Ballkan, por edhe më gjërë. Sipas tij, këtë sasi të drogës kanë pasur për qëllim që ta dërgojnë në Turqi.⁷¹

⁷⁰ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> .
parë më 05.08.2019.

⁷¹ <http://time.ikub.al/17-12-01-Zbulohet-droge-nga-laboratori-drogave-sintetike-ne-Tetove-FOTO-668505/Detaje-per-laboratorin-me-te-madh-ne-Ballkan-per-droge-sintetike.aspx>. parë më 10.08.2019.

3.3. Vjedhjet dhe llojet e vjedhjeve në rethin e Komunës së Tetovës

Vjedhjet janë forma më e përhapur dhe më masive e kriminalitetit e cila shpjegohet me marrjen e sendit të huaj me qëllim të përfitimeve personale dhe klasifikohet tek veprat penale kundër pasurisë. Vjedhjet zakonisht kryhen nga vjedhës profesionistë të cilët e realizojnë qëllimin e tyre në dy mënyra veprimesh, në mënyrë individuale ose në grupe të organizuara.⁷² Të gjitha llojet e veprës penale të vjedhjes mund të kryhet vetëm me dashje dhe konsiderohen se janë kryer kur sendi merret kundër vullnetit të pronarit dhe objekt i veprës penale të vjedhjes mund të jenë vetëm sendet e luajtshme që kanë vlerë ekonomike dhe që shërbejnë për plotësimin e nevojave të njeriut dhe jo edhe kur janë braktisur. Përveç veprës themelore të vjedhjes egzistojnë edhe forma të ndryshme të vjedhjes siç janë: vjedhja e formës së rëndë, grabitja, vjedhjet grabitqare, marja e sendeve të huaja, marja e automjetit etj.⁷³

Në vazhdim nëpërmjet tabelës 1 do të paraqesim numrin e vjedhjeve në Republikën e Maqedonis së Veriut të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendëshme, numrin e vjedhjeve në Komunën e Tetovës dhe Gostivarit të siguruara nga raportet e Sektorëve të Punëve të Brendëshme konkretisht Stacionet Policre Tetovë dhe Gostivarë.⁷⁴

Tabela 1.

		2013	2014	2015	2016	2017	2018
Maqedoni	Vepra	5.530	4.983	4.931	4.716	4.842	4.962
	Kryerës	1.878	1.974	2.142	2.141	1.802	2.025
Tetovë	Vepra	211	182	156	228	109	104
	Kryerës	55	122	125	192	76	76
Gostivar	Vepra	203	159	168	147	154	199
	Kryerës	52	36	81	94	65	127

Nga tabela e mësipërme vërejmë se numri i përgjithshëm i vjedhjeve të rëndomta në të gjithë RMV nga viti 2013 deri në vitin 2018 është 29.964 ku pjesmarës kanë qenë 11.962 persona. Nga 29.964 vjedhje, në Tetovë janë kryer 990 vjedhje nga 646 persona kurse në

⁷² Doc.dr.sc.Nedžad Korajlic, Metodika Kriminalistike (deliktete e gjakut, seksuale,pasurore), Sarajevë/Prishtinë 2007, Fq.118-119

⁷³ Dr.sc.Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq113-117.

⁷⁴ Të dhëna të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendëshme, Sektori i Punëve të Brendëshme Tetovë dhe Gostivarë, Tabela1, në datën 29.07.2019.

Gostivar janë raportuar 1.030 vjedhje dhe 455 persona. Bazuar në raportet vjetore, trajektorja e vjedhjeve brenda 6 viteve nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të madh në rritjen apo rrënien e veprave që do të thotë se kjo dukuri negative manifestohet me fluks përafërsisht të njëjtë çdo vit në vendin tonë.

Kjo vepër penale kundër pasurisë dënohet me Nenin 235 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonis së Veriut kështu: (1) Personi që konfiskon një send të luajtshëm nga një tjetër me qëllim të përvetësimit të paligjshëm të tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. (2) Nëse vlera e sendit të vjedhur është më e ulët dhe shkelësi kërkon të fitojë një objekt të një vlere të tillë, ai dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. (3) Ndëshkimi nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet edhe për kryesin që konfiskon pemë të huaj pyjore, sasia e së cilës është më e madhe se një metër kub me qëllim të përvetësimit të paligjshëm. (4) Përpjekja nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni do të dënohet. (5) Ndjekja për krimin nga paragrafi (2) i këtij neni do të ndërmerret padi private.⁷⁵

Sipas KP të RMV në Nenin 236 janë paraparë këto dënime për Vjedhjen e Rëndë dhe konsiderohet se është kryer: (1) Me thyerjen e hapsirave të mbyllura me qëllim të tejkalimit të pengesave të mëdha, Nga më shumë persona pjesmarës në vjedhje, kur kryhet në mënyrë të pacipë, me përdorimin e ndonjë arme të rrezikshme për sulm ose mbrojtje, duke shfrytëzuar fuqinë ose fatkeqësinë e një tjetri gjatë një zjarri, përmbytjeje ose një aksidenti të ngjashëm dhe për shfrytëzimin e pafuqisë ose fatkeqësinë e një tjetri, nëse objektet kanë vlerë më të madhe, kryesi dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet, dhe nëse objektet kanë vlerë të konsiderueshme, kryesi dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet. (2) Për vjedhjen e sendeve me vlerë të madhe, kryesi i veprës penale do të dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet. (3) Nëse sendi i vjedhur është nën mbrojtje të përkohshme, trashëgimi kulturore, gjë e rrallë natyrore ose pajisje ose send tjetër i një rëndësie të veçantë për sigurinë e njerëzve dhe pronave dhe sigurinë e transportit publik ose të një instalimi publik ose objekti në përdorim të përgjithshëm, kryesi dënohet me burgim të paktën katër vjet. (4) Nëse vlera e sendit të vjedhur nga paragrafi (1) i këtij neni është më e vogël dhe kryesi ka për qëllim të marrë një send me vlerë të tillë, ai dënohet me gjobë, ose me burgim deri në tre vjet.⁷⁶

⁷⁵ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> .
parë më 12.08.2019

⁷⁶ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> .
parë më 14.08.2019

Tabela 2

Numri total i vjedhjeve të rënda në RMV.⁷⁷

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Total
Vepra	15.109	13.110	10.432	10.858	11.229	10.788	71.526
Kryerës	5.494	4.492	3.568	4.111	4.060	3.923	25.648

Në tabelë vërejmë se nga viti 2019 deri në vitin 2018 janë raportuar gjithësej **71.526** vjedhje të rënda ku kanë qenë pjesmarës **25.648** persona, kurse numri më i madh i vjedhjeve të rënda dhe pjesmarësve në vjedhje shihet në vitin 2013. Gjatë periudhës kohore të 6 vjeçarit të fundit që morëm në studim në këtë punim për të gjitha veprat penale të parapara në këtë kapitull mund të konstatojmë se gjatë kësaj periudhe sipas raporteve të Ministris së Punëve të Brendëshe, Sektorit të punëve të Brendëshme në Tetovë dhe Sektorit për Punë të Brendëshme Gostivarë, ky krim ka depërtuar në të gjitha segmentet shoqërore me një numër të konsiderueshëm të vjedhjeve të formës së rëndë dhe ajo që është shqetësuese dhe që vihet re në këtë tabelë është prezenca dinamike e këtij lloj krimi dhe pjesëmarrja masovike e qyterarëve me këtë fenomen të rezikshmëm.

Tabela 3 - Tetovë

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Vepra	913	1.072	638	556	525	570
Kryerës	248	315	301	235	177	386

Tabela 4 - Gostivar

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Vepra	443	614	359	312	278	272
Kryerës	147	134	160	101	84	212

Në tabelën numër 3 kemi paraqitur numrin e raportuar të vjedhjeve të rënda në Tetovë dhe rethinën e Tetovës ku vërehet se në vitin 2013 ka pasur 913 vjedhje të kryera nga 248 persona, në vitin 2014 janë raportuar 1072 vjedhe dhe 315 pjesmarës, në vitin 2015 vjedhje 638

⁷⁷ Të dhëna të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendëshme, zyra e sigurisë publike, Departamenti i Inteligjencës dhe Analizave Penale dhe Sektori i Punëve të Brendëshme Tetovë dhe Gostivar, më datë 29.07.2019, Tabela 2, 3, 4.

pjesmarës 301, në 2016 vjedhje 556 dhe 235 pjesmarës, 525 vjedhje dhe 177 kryers janë raportuar në 2017 kurse në vitin 2018 janë raportuar 570 vjedhje dhe 386 pjesmarës. Numri më i madh i veprave të raportuara vërehet në vitin 2014 kurse në vitin 2018 vërehet numri më i madh i pjesmarësve në vjedhje të rënda në krahasim me 5 e mëparëshme që do të thotë se numri i vjedhjeve të rënda brenda 6 viteve ka vijuar në rritje kurse numri i pjesmarësve në vepra ka pësuar me ngritje. Pra nga viti 2013 deri në vitin 2018 në Tetovë gjithësej janë raportuar 4.274 vjedhje të rënda dhe 1.662 pjesmarës në këto vjedhje.

Vështruar në tabelen 4 vërmë se për periudhën kohore 6 vjeçare konkretisht nga viti 2013 deri në vitin 2018 në Gostivarë janë raportuar 2278 në total me 838 pjesarës. Më i shprehur ky krim ka qenë në vitin 2014 ku figurojn 614 raste të vjedhjeve të rënda, kurse më shumë pjesamrës me këtë aktivitet janë raportuar në vitin 2018. Krahasuar numrin e vjedhjeve nga viti 2013 deri në vitin 2018 midis Tetovës dhe Gostivarit shihet qartë se në Tetovë dukuria e vjedhjes është më e shprehur ku për çdo vit raportohet mbi 200 vjedhe të rënda dhe afër 100 pjesmarës më shumë se në Gostivar. Nga numri total i vjedhjeve të rënda (71.526) dhe pjesmarësve (25.648) që janë raportuar në të gjithë shtetin tonë vetëm 6.552 vjedhje të rëna nga 2.500 persona janë kryer në Tetovë dhe Gostivar.

Përveç vjedhjes së rëndë, si vepra penale kundër pasurisë në Kodin Penal të Maqedonisë janë paraparë Grabitja dhe Vjedhjet Grabitqare. Grabitja dënohet me Nenin 237 dhe konsiderohet se është kryer kur: (1) Një person i cili, me përdorimin e forcës ose kërcënimit e sulmon drejtpërdrejt jetën ose trupin e një tjetri, që të konfiskojë një send të luajtshëm me qëllim të përvetësimit të paligjshëm të tij do të dënohet me burgim së paku pesë vjet. (2) Nëse vlera e objektit të sekuestruar është e një shkalle të madhe, kryesi dënohet me burgim të paktën tetë vjet. (3) Nëse vlera e objektit të konfiskuar është më e vogël, kryesi dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. (4) Nëse gjatë kryerjes së krimit nga pika 1 personit i është shkaktuar me dashje dëm i rëndë trupor ose nëse vepra është kryer si grup, bandë ose nëse është përdorur armë zjarri ose armë e rrezikshme, kryesi dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet. (5) Nëse gjatë kryerjes së krimit nga paragrafi 1 personi qëllimisht është privuar nga jeta, kryerësi dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose me burg të përjetshëm, kurse Vjedhja Grabitqare dënohet me Nenin 238 të KPM-së dhe është paraparë kështu: 1) Ai që kapet në vjedhje dhe përdorë forcën ose kërcënimin që të sulmojë menjëherë jetën ose trupin e një tjetri me qëllim të mbajtjes së sendit të vjedhur, dënohet me burgim të paktën pesë vjet. 2) Nëse vlera e sendeve të vjedhura është e madhe, kryesi dënohet me burgim të paktën tetë vjet. 3) Nëse vlera e sendit të konfiskuar është e vogël dhe shkelësi shkon për të fituar një objekt të një vlere të tillë, ai

dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. 4) Nëse gjatë krimit nga paragrafi 1) deri në 3) të këtij neni një personi i është shkaktuar me dashje lëndim i rëndë trupor ose nëse grabitja është kryer si grup ose bandë ose nëse është përdorur armë zjarri ose instrument i rrezikshëm ose nëse jeta ose trupi i dy ose më shumë personave është rrezikuar gjatë kryerjes së krimit në një bankë, zyrë shkëmbimi, zyrë postare ose vend publik, kryerësi dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet. 5) Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1) personi është privuar nga jeta me dashje, kryesi dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.⁷⁸

Në tabelën numër 5 do të paraqesim numrin total të grabitjeve dhe vjedhjeve grabitqare në të gjithë RMV dhe do ti krahasojmë se sa nga totali i veprave janë kryer në Tetovë dhe Gostivar.⁷⁹

Tabela 5

GRABITJET							
		2013	2014	2015	2016	2017	2018
RMV	Vepra	468	305	278	248	417	383
	Kryerësve	344	256	290	160	264	239
Tetovë	Vepra	21	12	11	5	6	13
	Kryerësve	27	5	15	4	13	13
Gostivar	Vepra	10	5	6	6	4	13
	Kryerësve	5	4	6	9	3	10

Tabela 6

Vjedhjet grabitqare							
		2013	2014	2015	2016	2017	2018
RMV	Vepra	39	49	34	39	55	53
	Kryerësve	53	47	33	49	46	38
Tetovë	Vepra	1	1	1	1	4	3
	Kryerësve	2	0	1	0	3	2
Gostivar	Vepra	1	0	2	2	1	0
	Kryerësve	0	0	2	2	0	0

⁷⁸ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> parë më 18.08.2019.

⁷⁹ Të dhëna të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, zyra e sigurisë publike, Departamenti i Inteligjencës dhe Analizave Penale dhe Sektori i Punëve të Brendshme Tetovë dhe Gostivar, më datë 12.08.2019, tabela 5, 6.

Nga tabela vërejmë se nga viti 2013 deri në vitin 2018 në RMV në total janë raportuar 2099 grabitje dhe janë raportuar 1553 persona, kurse në vitin 2013 vërehet një ritje e konsiderueshme e grabitjeve dhe pjesmarëve në grabitje që në vitet tjera ka vijuar me ulje. Nga numri total i grabitjeve vetëm në Tetovë janë raportuar 68 grabitje dhe 77 kryers, kurse në Gostivar 44 vepra dhe 37 persona, krahasuar në trajektoren e agravimit shifet se në Tetovë numri më i madh i grabitjeve dhe pjesmarësve në grabitje figuron në vitin 2013 që më pas në vitet në vazhdim ka pësuar rënie, kurse në Gostivar në vitin 2018 grabitja ka pasuar me rritje.

Sa i përket rasteve të vjedhjeve grabitqare në vendin tonë nga viti 2013 deri në vitin 2018 gjithësej janë raportuar 269 raste dhe 266 pjesmarës, kurse në Tetovë janë raportuar gjithësej 11 vjedhje grabitqare dhe 8 persona, ajo që bie në sy në tabelën e raboteve të vjedhjeve grabitqare është se në vitin 2014 dhe 2016 janë raportuar nga një vjedhje por nuk është raportuar asnjë kryers që do të thotë se kryersit e vjedhjeve kanë ngelur të pazbuluar, kurse në Gostivarë për 6 vite janë raportuar 6 vjedhje grabitqare dhe 4 persona, pra në vitin 2013 është raportuar 1 vjedhje dhe kryersi ka ngelur i pazbuluar, në 2014 nuk është raportuar asnjë vjedhje, në 2015 janë raportuar 2 vjedhje grabitqare dhe 2 kryers, po ashtu edhe në 2016 janë raportuar 2 kryers dhe 2 vjedhje, 1 vjedhje dhe asnjë person në 2017 dhe në 2018 asnjë vjedhje dhe asnjë kryers.

Me gjithë faktet e përmendura më sipër, në bazë të shënimeve statistikore nga Ministria e Punëve të Brendëshme konkretisht nga Zyra e Sigurisë Publike, Departamenti i Inteligjencës dhe Analizave Penale dhe Sektori i Punëve të Brendëshme Tetovë dhe Gostivar, vërejmë se numri i krimeve kundër pasurisë konkretisht Grabitjes dhe Vjedhjeve Grabitqare nuk është raportuar i saktë. Krahasuar dhe bazuar nga permanenca e përditshmërisë mund të theksojmë se shumë vepra të këtij lloji dhe shumë aktivistë të kyçur në këto aktivitete kanë ngelur të pazbuluar. Gjykuar nga gjendja aktuale dhe faktike e manifestimit të veprave penale kundër pasurisë në vendin tonë lirshëm mund të përfundojmë se dukuria e vjedhjes pavarsisht llojit të saj, qëndron në rend të parë e cila çdo ditë në masë të madhe agrava në rritje.

3.4. Viktimat e vrasjeve në Komunën e Tetovës

Duke pasur parasysh se të gjithë njerëzit lindin të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave të njeriut, përgjegjësia për mbrojtjen e këtyre të drejtave që mund të atakohen në moment dhe kohë bie mbi shtetin, mirëpo ato që u japin të drejtave të njeriut strukturën ditore dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme janë: të kuptuarit, respektimi dhe parashikimet e çdo personi individual për të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut ofrojnë bazën e nevojshme mbi të cilën do të vazhdohej zhvillimi njerëzorë dhe siguria njerëzore, të cilat edhe u japin fuqi individëve dhe shoqërisë në realizim të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut. Sidoqoftë të drejtat e njeriut mund të kufizohen nga të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose nga kërkesat morale, publike ose të rendit publik dhe mirëqenies së përgjithëshme të një shoqërie demokratike. Mbase mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejtë akteve barbare të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit dhe kanë cënuar të drejtën e njeriut për jetë dhe mbasi është e domosdoshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, Asambleja e Përgjithëshme në 10 Dhjetorë të vitit 1948 shpalli Deklaratën e Përgjithëshme Mbi të Drejtat e Njeriut si ideal të përgjithëshëm për të gjitha shtetet. Në Deklaratën e Përgjithëshme Mbi Të Drejtat e Njeriut në Nenin 1 citohet se: Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vllazërimi. Në Neni 2 citohet se: Secili gëzonë të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetarë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjerë. Neni i 3 thotë se: Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurim vetjak. Neni 5 thotë: Asnjëri nuk duhet ti nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzorë ose poshtërues. Në Nenin 7 citohet se: Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji.⁸⁰

Në Republikën e Maqedonisë jeta e njeriut është ngritur në rang kushtetues edhe atë në Nenin 10 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë citohet se: Jeta e njeriut është e pacënueshme. Në R.M nuk mund të shqiptohet dënim me vdekje në asnjë lloj baze, kurse Neni 11 thotë se: Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzorë dhe poshtërues.⁸¹ Prandaj pa dyshim që veprat penale kundër jetës klasifikohen si vepra shumë të rënda penale sepse jeta e njeriut dhe mbrojtja e jetës së njeriut ka karakter absolut, në kuptimin

⁸⁰ https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf: parë më 23.08.2019.

⁸¹ <https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf> : parë më 28.08.2019.

që jeta mbrohet pa marrë parasysh ndjenjën për jetë, interesin jetësorë të individit, pa marrë parasyshë vlerësimin e jetës së individit nga ana e shoqërisë, dhe pa marrë parasyshë se për cilën fazë të jetës bëhet fjalë, megjithatë përjashtimet për respektin absolut të jetës së njeriut egzistojnë vetëm në raste luftime, dënimit me vdekje në bazë të disa legjislacioneve, dhe vrasja në mbrojtje ekstreme. Veprat penale kundër jetës dhe trupit shprehen si një raportë i drejtëpërdrejtë fizik midis kryesit dhe viktimës që presupozon se në veprën penale kontribut të madh jep edhe vet objekti i sulmit pra viktimë. Njeriu ka liri absolute të disponimit me jetën e vetë dhe integritetin truporë andaj vetëvrasja dhe vetëlëndimi nuk rangohen si vepra penale, përveç se kur paraqet mënyrë të rrezikimit të të mirave tjera shoqërore.⁸²

Me vrasje nënkupojmë atë veprë të kundërligjshme me anë të së cilës i meritë jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes egzistojnë edhe vepra të kualifikuara dhe të privileguara të vrasjes të cilat dallohen nga mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rethanat subjektive mirëpo objekti i mbrojtjes është jeta e njeriut sepse pasoja qëndron në paraqitjen e vdekjes.⁸³

Viktimat kundër jetës dhe trupit zakonishtë rrjedhin nga rastet e veprave penale të vrasjeve, plagosjeve dhe lëndimeve trupore, shtytjeve në vetëvrasje dhe ndihmës në vetvrasje, pjesmarjes në rrahje, vjedhjeve me pasoja të vdekjes apo me lëndime të rënda trupore. Ndonëse për krimet kundër jetës dhe trupit konkretishtë vrasjes dhe viktimas, janë bërë shumë hulumtime kriminologjike dhe viktimologjike del se ato shpesh janë të nxitura nga sulmi dhe atakimi fizik i vetë viktimës ndaj kryesit, kjo do të thotë se viktimë në të shumtën e rasteve vetë e provokon, përshpejton, e ndihmon dhe e lehtëson kryerjen e vrasjes. Përveç hulumtime të reaksionit ndërmjet kryesit dhe viktimës, hulumtime të shumta janë bërë edhe për moshën, motivet, lidhshmerinë, gjininë që del se moshë e viktimave të vrasjes përputhet me moshën e kryesve të tyre dhe më shpesh paraqiten personat mes moshës 20-45 vjeç mirëpo nuk përjashtohen as grupmoshat e ndryshme kurse fëmijët dhe të miturit bëhen viktimë të vrasjeve rrallë, motivet dhe shrytjet lidhen me menjanimin e pengesave për realizimin e planit dhe synimit të kryesit për aritjen e përfitimeve materiale, po ashtu konstatohet se në të shumtën e rasteve viktimë dhe kryesi janë të njohur ndërmjet kurse rastet ku kryesi dhe viktimë nuk njihen fare janë të ralla,

⁸² Dr. Sc. Ismail Zejneli, E DREJTA PENALE-Pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq 17,18.

⁸³ Po aty, fq.

kurse sa i përket gjinisë së viktimave dhe krimeve të vrasjes më shumë pjesëmarës paraqiten gjinia mashkullore.⁸⁴

Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë në Nenin 123 për veprën penale të vrasjes janë paraparë këto dënime: (1) Ai i cili e privon një tjetër nga jeta e tij, dënohet me burgim së paku pesë vjet. (2) Me burg të paktën dhjetë vjet ose do të dënohet me burg të përjetshëm ai që: 1) Tjetrin do ta privoj nga jeta në mënyrë mizore dhe tinëzare. 2) Tjetrin do ta privoj nga jeta gjatë dhunës në familje. 3) Tjetrin do ta privoj nga jeta dhe do të rrezikoj me dashje jetën e një personi tjetër. 4) Do të privojë një tjetër nga jeta e tij me qëllim të kryerjes ose fshehjes së një krimi tjetër. 5) Privon një tjetër nga jeta në bazë të porosis. 6) Do të privojë nga jeta një grua për të cilën është në dijeni se është shtatzënë. 7) Privon nga jeta një gjyqtar, prokuror publik ose avokat gjatë kryerjes së funksionit të tij ose të saj, ose personit zyrtar ose ushtarak, në kryerjen e çështjeve të sigurisë publike ose të shtetit ose në detyrën e ruajtjes së rendit publik, kapjen e një kryesi ose mbajtjen e një procesi penal.⁸⁵

Te vrasja në menyrë mizore kemi të bëjmë me rastet ku objektivi i kryerjes është që ti shkaktoj vuajtje të mëdha fizike dhe psikike viktimës kurse te vrasja në mënyrë tinëzore elementi objektiv është se kryesi vepron në mënyrë të fshehtë, mashtruese kurse elementi subjektiv qëndron te dinakëria, kjo vrasje kryhet vetem me dashje direkte. Vrasja me dashje me çrast rrezikohet jeta e personave të tjerë ka bëjë me rastet kur kryesi për ta kryer veprën e caktuar pajtohet me vetëdije të plotë që ta vejë në rrezik edhe jetën e personave të tjerë pra kjo veprë penale konsiderohet se egziston atëherë kur përvec viktimës së vrasjes edhe jeta e një apo më shumë personave të tjerë ka qenë produkt i kësaj veprë. Te vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale personi, privohet nga jeta për dy qëllime ose që të bëjë të mundëshme kryerjen e veprës penale ose e privon tjetrin nga jeta me qëllim që të pengoj zbulimin e veprës penale që e ka kryer më parë apo është në proces të kryerjes. Për dallim nga vrasjet tjera te vrasja në bazë të porosisë kemi të bëjmë me vrasje të organizuar ku pjesëmarës janë dy persona porositësi dhe kryesi dhe realizohet për motive të ndryshme si lidhje politike, ekonomike ku porositësi përgjigjet si nxitës i vrasjes së rëndë. Vrasja e gruas shtatzënë ka të bëjë me marrjen e dy jetëve, jetën e gruas shtatzënë dhe jetën e fëmijës ende të pa lindur apo ndërprerjen e jetës së ardhëshme. Kjo veprë konsiderohet e kualifikuar nëse kryesi ka qenë në

⁸⁴ Dr.Ragip Halili, VIKTIMOLOGJIA, Prishtinë 2007, fq63-69.

⁸⁵ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>: parë më: 03.09.2019

dijeni se viktima është shtatzënë por në qofte se jo atëher kryersi do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë apo për ndonjë lloj tjetër të vrasjes së rëndë varësisht nga rrethanat e kryerjes.⁸⁶

Në Kodin Penal të RMV në Nenin janë paraparë edhe këto vepra penale kundër jetës: **Vrasja nga motivet fisnike** në Nenin 124 ku citohet se: Kushdo që privon një tjetër nga jeta e tij për çështje fisnike, do të dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burg, **Vrasje nga pakujdesia** në Nenin 126 për të cilën parashihet kështu: Kushdo që privon nga jeta e tij një person nga pakujdesia, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, dhe në Nenin 127 është paraparë **Vrasja e foshnjës gjatë lindjes** kështu: (1) Nëna që privon fëmijën e saj nga jeta gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes nën ndikimin e ndonjë çrregullimi të shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet. (2) Përpjekja është e dënueshme.⁸⁷

Në vazhdim nëpërmjet tabelës 1 do të paraqen numrin e raportuar të veprave penale kundër jetës, të kryersve të veprës penale dhe viktimave në të gjithë teritorin e Republiës së Maqedonisë së Veriut të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendëshme.⁸⁸

Tabela 1

R.M.V.						
Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Vepra	20	26	22	17	27	18
Kryerës	18	27	24	20	25	33
Viktima	22	34	25	18	32	21

Vështruar në tabelën numër 1 vërejmë se në vitin 2013 janë raportuar 20 vepra, 18 kryers dhe 22 viktima, në 2014 janë raportuar 26 vepra 27 pjesmarës dhe 24 viktima, në 2015 janë raportuar 22 vepra penale kundër jetës 24 pjesmarës në këto vepra dhe 25 viktima, 17 vepra 20 kryers dhe 18 viktima janë raportuar në 2016, në 2017 janë raportuar 27 vepra penale 25 kryers dhe 32 viktima kurse 18 vepra 33 kryers dhe 21 viktima janë raportuar në vitin 2018. Sipas të dhënave në tabelën e më sipërme pikërisht tek viti 2014 shikojmë numër më të lartë të veprave penale kundër jetës dhe numër më të madh të viktimave, kurse viti i pjesmarësve me këtë vepër është viti 2018 që do të thotë se numri i veprave dhe viktimave ka pësuar rënie kurse i kryersve

⁸⁶ Dr.sc.Ismail Zejneli, E DREJTA PENALE-Pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq19-25.

⁸⁷ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> parë më: 05.09.2019.

⁸⁸ Të dhëna statistikore të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendëshme gjejmësishtë Zyra e Sigurisë Publike dhe Departamenti i Inteligjencës dhe Analizave Penale më datë 29.07.2019

a proçeduar me ritje. Ne Republikën e Maqedonis së Veriut në total janë raportuar 130 vepra penale, 147 kryers pa dallim gjinie dhe 152 viktima pa dallim moshe, gjine, race, etniteti.

Nëpërmjet tabelës numër 2 do të paraqes të dhëna statistikore për veprat penale kundër jetës, pjesmarësit në këto vepra dhe viktimat në Tetovë dhe Gostivar të siguruara nga Sektori i Punëve të Brendëshme konkretishtë nga Stacioni Policorë tetovë dhe Gostivarë.⁸⁹

Tabela 2

	Viti	2013	2014	2015	20169	2017	2018
Tetovë	Vepra	2	1	5	1	2	2
	Kryerës	1	1	9	2	1	13
	Viktima	2	1	6	1	2	2
Gostivar	Vepra	1	2	2	1	1	0
	Kryerës	1	2	1	1	1	0
	Viktima	2	2	2	1	1	0

Nga të dhënat e paraqitura ne tabelën më larë vërjejmë se nga viti 2013deri në vitin 2018 në Tetovë numri përgjithshëm i veprave penale kundër jetës është 13, ka psaur 27 kryers dhe 14 viktima. Numri më i madh i veprave dhe viktimave është raportuar në vitin2015 kursenë vitin 2018 janë raportuar mëshumë kryers. Në Gostivar gjatë këtyre gjashtë viteve që kemi marrë në studim në total janë raportuar 8 viktima prej 8 veprave penale dhe 9 pjesmarës. Totali i veprave që janë raportuar në Tetovë dhe Gostivar është 21, numri total i kryersve është 36 dhe janë raportuar 28 viktima pa dallim moshe, gjinie, feje, etniteti etj. Bazuar ne tabelën me të dhënat statistikore mund të konstatojmë se në Tetovë manifestohet më me fluks kjo vepërpenale dhe është më e rrezikuar nga ky fenomen në krahasim me qytetine Gostivarit.

3.5. Trafikimi me njerëz në Republikën e Maqedonisë

Trafikimi i qenieve njerzore është një problem serioz ndërkombëtarë nëpërmjet të cilit bëhet shfytëzimi i trupit dhe punës së njeriut me çrast ju shkelet e drejta e jetës, lirisë, shëndetit, punës, arsimit dhe të sigurisë. Viktimë e trafikimit me njerëz mund të jetë çdo person apo individë pa dallim moshe, feje, gjinie, etniteti etj. Trafikim përfshinë rekrutimin, transportimin,

⁸⁹ Të dhëna të siguruara nga Setori për Punë të Brendëshme, Stacioni Policor Tetovë dhe Gostivar, më 29.07.2019.

transferimin, blerjen, shitjen, pranimin apo strehimin e personave të trafikuar dhe më pas proçedohet me shfrytëzimin e tyre për abuzime të ndryshme seksuale, për punë me detyrim me pagesë të ulët ose pa pagesë, për tregti organesh, për të kryer krime, detyrim në lypje, martesë kundër vullnetit të lirë dhe tjera, kurse trafikantët objektivin e arrijnë nëpërmjet përdorimit të forcës, kanosjes serioze ose formave tjera të shtrëngimit, mashtrimit, keqpërdorimit të fuqisë apo pafuqisë etj.⁹⁰

Krimet e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh kryhen dhe kanë efekte në më shumë se një vend. Nga ana tjetër, kundërpërgjigjet e drejtësisë penale ndaj trafikimit të qenieve njerëzore (ligjet penale, agjencitë e forcave të ligjit, prokuroritë dhe gjykatat) normalisht janë strukturuar dhe shpesh veprojnë vetëm brenda kufijve të një vendi. Kjo mospërputhje përbën një sfidë të rëndësishme ndaj aftësisë së vendeve për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e trafikimit të qenieve njerëzore, prandaj ky krim mund të sfidohet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtarë.⁹¹

Si faktorë që kontribuojnë për fenomenin e trafikimit në Republikën e Maqedonis së Veriut citohen vështirësitë socio - ekonomike që rezultojnë me varfëri dhe shkallë të lartë të papunësisë si dhe institucione të dobëta dhe joefikase të cilat ndihmojnë në shtim të krimit të organizuar dhe korupsionit.⁹² Sa i përket trafikimit me njerëz Maqedonia në vitin 2004 ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar trans-nacional së ashku me Protokollin mbi parandalimin dhe ndëshkimin e trafikimit me njerëz, posaçërishtë me femra dhe fëmijë si dhe Protokollin mbi parandalimin e trafikimit me emigrantë. Gjithashtu Maqedonia është palë nënshkruese e një numri të madh të marrveshjeve bilaterale në aspektin e ndihmës reciproke me qëllim të parandalimit të krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit ndërkombëtarë me Shqipëri, Bullgarinë, Kroacinë, Rumaninë, Slloveninë, Malin e Zi dhe Republikën Arabe të Egjiptit.⁹³

Trafikimi i qenieve njerëzore në Kodin Penal të R.M.V është paraparë në Nenin 418-a siç varion:

⁹⁰ ESB-Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave, Udhëzues mbrojtje të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, Shkup 2017, fq.5-6.

⁹¹ <https://www.unodc.org/documents/southeasterneurope/Guidelines-Macedonian.pdf>. parë më: 12.09.2019

⁹² Qendra për kërkime shkencore e fakultetit juridik-UEJL, Vasko Dimishkov, Trafikimi me njerëz, Aspektet Juridike, Mars 2007, fq.75.

⁹³ Qendra për Kërkime Shkencore e Fakultetit-UEJL, Trafikimi me Njerëzore-Aspektet Juridike, Mr.Besa Arifi, Ndihma juridike reciproke në luftimin e trafikimit me qeniet njezore, Fq.134-135.

(1) Një person i cili me forcë, kërcënim serioz çon në mashtrim ose forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pozitës ose gjendjes së tij të shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore të një tjetri, ose duke dhënë ose marrë para ose përfitime të tjera me qëllim të marrjes së pëlqimit të një personi që ka kontrollin e një personi tjetër, ose në të kundërtë rekrutimin, transportimin, transferimin, blerjen, shitjen, strehimin ose pranimin e personave me qëllim prostitucioni ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, pornografia, puna ose servituti i detyruar, skllavëria, martesat e detyruara, fekondimi i detyruar, adoptimi i paligjshëm ose marrëdhënie të ngjashme ose transplantimi i paautorizuar i pjesëve të trupit të njeriut, dënohet me burgim të paktën katër vjet. (2) Personi që sekuestron ose shkatërron një letërnjoftim, pasaportë ose dokument tjetër të identifikimit të huaj me qëllim të kryerjes së krimit nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me burgim së paku katër vjet. (3) Ai që përdor ose lejon një tjetër të përdorë shërbime seksuale ose forma të tjera të shfrytëzimit nga personi që ka dijëni se është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. (4) Nëse krimi nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni është kryer nga një zyrtar në kryerjen e shërbimit të tij, ai / ajo dënohet me burgim të paktën tetë vjet. (5) Pëlqimi i viktimës së trafikimit për qëllimet e shfrytëzimit i parashikuar në paragrafin 1 nuk do të jetë i rëndësishëm për ekzistencën e veprës penale të përmendur në paragrafin 1. (6) Nëse vepra penale nga ky nen është kryer nga një person juridik, dënohet me gjobë. (7) Pasuritë e paluajtshme dhe mjetet e transportit të përdorura për kryerjen e veprës penale konfiskohen, kurse trafikimi i të miturve është paraparë në **Nenin 418**-g siç varion: (1) Personi që rekruton, transporton, transferon, blen, shet, strehon ose pranon një të mitur me qëllim prostitucioni ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, pornografisë, punës së detyruar punë ose servilizëm, skllavëri, martesa të detyruara, punë e detyruar, fekondim, birësim i paligjshëm ose një marrëdhënie e ngjashme ose transplantimi i papranueshëm i pjesëve të trupit të njeriut do të dënohet me burgim të paktën tetë vjet. (2) Ai i cili kryen veprën penale nga paragrafi 1 me forcë, kërcënim serioz, keqpërdorim ose formë tjetër të shtrëngimit, rrëmbim, mashtrim, abuzim të pozitës ose gjendjes së tij të shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore ndaj një tjetri, ose duke dhënë ose marrë para ose përfitime të tjera për të marrë pëlqimin e personit që ka kontrollin e një personi tjetër, dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet. (3) Ai person që përdor ose i mundëson një tjetri të përdorë shërbime seksuale ose forma të tjera të shfrytëzimit nga një i mituri për të cilin ai e dinte se është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim të paktën tetë vjet. (4) Personi që sekuestron ose shkatërron një letërnjoftim, pasaportë ose dokument tjetër të identifikimit të huaj me qëllim të kryerjes së krimit nga paragrafët 1 dhe 2, dënohet me burgim të paktën katër vjet. (5) Nëse vepra penale nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni është kryer nga një

zyrtar gjatë shërbimit të tij dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet. (6) Pëlqimi i të miturit me veprimet e parashikuara në paragrafin 1 nuk është i rëndësishëm për ekzistencën e veprës penale nga paragrafi 1. (7) Nëse vepra penale nga ky nen është kryer nga një person juridik, dënohet me gjobë. (8) Pasuritë e paluajjtshme të përdorura, sendet dhe mjetet e transportit të përdorura për kryerjen e krimit konfiskohen.⁹⁴

Nëpërmjet tabelës që do të paraqesim më poshtë do të tregojmë se sa raste të veprës penale të trafikimit me njerëz janë raportuar në të gjithë R.M.V brenda periudhës kohore 6 vjeçare, konkretisht nga viti 2013 deri në vitin 2018. Numri i raporteve është i siguar nga Ministria e Punëve të Brendshme konkretisht nga Zyra e Sigurisë Publike dhe Departamentit i Intelejencës dhe Analizave Penale.⁹⁵

Tabela 1

		RMV					
	Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2108
Trafikimi me njerëz	Vepra	0	1	0	1	0	0
	Kryerës	0	1	0	6	0	0
Trafikimi me të mitur	Vepra	1	0	2	5	1	10
	Kryerës	1	0	3	11	1	16

Në tabelën e paraqitur me numër 1 brenda 6 vjeçarit që morëm në studim për trafikimin me njerëz vërejmë se nga viti 2013 deri në vitin 2018 gjithësej në Republikën e Maqedons së Veriut janë raportuar 2 vepra dhe 6 pjesmarës, pra vetëm 1 vepër dhe 1 kryerës është raportuar në vitin 2014 dhe në vitin 2016 është raportuar një vepër dhe 6 pjesmarës kurse në vitet tjera nuk është raportuar as vepër as kryerës. Kurse vepra penale Trafikim me të mitur nga viti 2013 deri në vitin 2018 në total janë raportuar 19 dhe 32 pjesmares, i vetmi vit që nuk është raportuar asnjë rast është viti 2014, nga një rast dhe një kryerës është raportuar në vitin 2013 dhe në vitin 2017, 2 vepra dhe 3 pjesmarës janë raportuar në vitin 2015, kurse në vitin 2016 e sidomon në 2018 janë raportuar më shumë raste, gjë që tregon se aktualisht trafikimi i të miturve është në rritje permanente.

⁹⁴ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>. Neni 418-a, Neni 418-g, parë më: 17.09.2019

⁹⁵ Të dhëna të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Sigurisë Publike, Departamenti i Intelejencës dhe Analizave Penale, më datë 29.07.2019.

Në tabelën numër 2 do të paraqes poashtu statistika të siguruara nga Sektoret për Punë të Brendëshme konkretisht Stacioni Policor Tetovë dhe Gostivar mbi numrin e raportuar të veprave të trafikimit me njerëz dhe të mitur dhe numrin e kryersve apo pjesmarësve në këtë vepër penale.⁹⁶

Tabela 2

Tetovë							
	Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2108
Trafikimi me njerëz	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0
Trafikimi me të mitur	Vepra	1	0	2	5	1	10
	Kryerës	1	0	3	11	1	16

Tabela 3

Gostivar							
	Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2108
Trafikimi me njerëz	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0
Trafikimi me të mitur	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0

Bazuar në tabelë vërejmë se në Tetovë dhe Gostivarë nga vtit 2013 deri në 2018 nuk është raportuar asnjë vepër penale e trafikimit me njerëz dhe asnjë vepër penale e trafikimi me fëmijë të moshës minorene dhe asnjë kryers për 6 vitet e fundit!.

⁹⁶ Të dhëna të siguruara nga Sektori për Punë të Brendëshme Tetovë dhe Gostivarë konkretisht Stacioni Policorë në Tetovë dhe Gostivar, më datë:29.07.2019.

Kapitulli IV

4. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT

4.1. Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit në Komunën e Tetovës

Policia ka një rol shumë delikat dhe të rëndësishëm në preventivën, zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit e cila funksionin dhe veprimtarinë e saj kryesore e zbaton gjithmonë konform ligjeve të miratuara.⁹⁷ Policia është një organ që, jo vetëm parandalon kryerjen e veprave penale, por edhe godet grupe kriminale, ushtron kontrole të ndryshme për kapjen e elementeve të rrezikëshme për ti vënë ato para drejtësisë.⁹⁸

Aktiviteti i policisë i cili është i drejtuar në eliminimin e rrethanave dhe shkaktarëve të paraqitjes së sjelljes kriminale karakterizohet si preventiv, pra fjala është për grupin e masave të cilat kryhen para kryerjes së krimit e më të cilat kryesit i pamundësohet kryerja e akteve kundërligjore dhe të rrezikshme për shoqërinë. Si masa më të zbatuara policore që kanë karakter preventiv mund të përmenden: Shërbimi patrullues, mbikëqyrja dhe sigurimi i objekteve, shërbimi paralajmërues, verifikimi i identitetit, kontrolli i komunikacionit publik, informimi i qytetarëve dhe puna në komunitet, ndërmjetësimi jo formal në zgjidhjen e konflikteve, bashkëpunimi brenda organizatave policore ndërkombëtare etj, mirëpo aktivitetet e policisë më së shumti janë të drejtuara në ato masa që kanë karakter represiv për të cilat duhet të ndërmer veprime të caktuara pas kryerjes së krimit, që kanë të bëjnë me: Zbulimin e veprës penale apo çdo vepre tjetër që është në kundërshtim me ligjin, zbulimin e kryesit të asaj vepre, sigurimin e pranisë së kryesit, paraqitjen e dëshmive të rëndësishëm për procedurën penale, sigurimin e disa dëshmive etj. Që të mund ti përdorë policia këto mjete të karakterit represiv të cilat seriozisht cenojnë jetën private të të drejtave dhe lirive qytetare, është e domosdoshme të ekzistojnë: Kushtet ligjore dhe vlerësimet reale për domosdoshmërinë e tyre (vendimi i gjykatës kompetente)⁹⁹.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kompetencat policore për parandalimin e kriminaliteiti janë të rregulluara me ligjin e policisë në Nenin 28 siç varijon: Policia është

⁹⁷ Fatos Haziri, E drejta e policisë, Prishtinë 2010, fq.164-165

⁹⁸ Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq.257.

⁹⁹ Muhamed Budimlić, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë 2006, fq.66-68

kompetente për 1) kontrollimin dhe përcaktimin e identitetit të personave dhe sendeve; 2) mbledhjen e informacionit; 3) referencën; 4) privimin e lirisë; 5) kapjen; 6) ndalimin; 7) kërkimin e personave dhe të sendeve; 8) veprim të fshehtë policor; 9) ridrejtimin, drejtimin ose kufizimin e lëvizjes së personave dhe mjeteve të transportit në një hapësirë të caktuar për kohën e nevojshme; 10) paralajmërim dhe rregullim; 11) konfiskimin e përkohshëm të sendeve; 12) inspektimin ose kontrollimin e objekteve dhe hapësirave të caktuara të organeve shtetërore, institucioneve që kryejnë autorizime publike dhe personave të tjerë juridikë dhe inspektimin e një dokumentacioni të caktuar të tyre; 13) hyrjen në një shtëpi të huaj dhe ambiente të tjera të mbyllura; 14) frenimin, inspektimin ose kontrollimin e personave, bagazheve dhe mjeteve të transportit; 15) sigurinë dhe inspektimin e vendit të ngjarjes; 16) Pranimin e raporteve dhe ankesave, paraqitjen e raporteve dhe njoftimeve; 17) njohjen; 18) shpalljen publike të një shpërblimi; 19) prova poligrafike; 20) mbledhjen, përpunimin, analizimin, përdorimin, vlerësimin, transferimin, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave, si dhe përpunimin e të dhënave personale në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë dhe ligj të veçantë; 21) aplikimin e masave speciale hetimore dhe 22) mbrojtjen e personave të përfshirë në rregulloret për mbrojtjen e dëshmitarëve.¹⁰⁰

Disa veprime tjera të karakterit parandalues që ndërmer policia për të luftuar kriminalitetin janë: patrullimi dhe vëzhgimi, racia, prita, flagrancia, mbikqyrja e të dënuarve etj. Patrullimi dhe vëzhgimi janë veprime që ndërmeren me qëllim që tu pamundësohet liria e veprimit kriminelëve, racia është aksion operativ i rufeshë dhe i përgaditur mirë e cila ndërmeret në kohë të caktuar pas njoftimit se në vend të caktuar gjenden personat që kërkohen, prita është aksion i fshehtë policorë që nënkupton shpërndarjen e fshetë të policëve në vend të caktuar me qëllim që fajtori të kapet në mënyrë të befasishme, flagrancia është aksioni policor që ndërmeret për të kapur fajtorin në momentin e ndërmarjes së veprimit, kurse mbikqyrja e të dënuarve është masë që ndërmeret nga ana e policisë ndaj të dënuarve konkretishtë ndaj atyre që kanë kryer mëherët vepra penale për të cilët egziston dyshimi se do të përsëritin kryerjen e veprave penale. Kategori e personave të tillë zakonishtë paraqiten falsifikuesit e parave, mashtruesit, kontrabanduesit e armëve, automjetëve, substancave të ndryshme narkotike etj.¹⁰¹

Në organizatën policore udhëheqja dallohet për nga efikasiteti i saj andaj duke pas parasysh kompleksitetin dhe multidimensionalitetin e formave të ndryshme të kriminalitetit, policia gjatë

¹⁰⁰ <http://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf> .
parë më 19.10.2019.

¹⁰¹ Fitim Shishani, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, Prishtinë 2006, fq.96,103,106,110.

luftimit të kriminalitetit paraprakisht duhet të dëshmojë kualitetin dhe peshën e saj në parandalimin dhe luftimin e tij. Policia për të pasur efikasitet dhe për të arritur efektivitetin duhet ti kuptoj mirë problemet e realitetit shoqërorë të kohës. Nëse ajo këtë nuk është në gjendje ta bëjë, atëherë në mënyrë të pashmangshme do të jetë e dështuar në improvizim.¹⁰²

Në vazhdim nëpërmjet tabelës që do të paraqes më poshtë do të japim një pasqyrë statistikore mbi zbulimin e veprave penale dhe kapjen e autorëve të po të njejtave vepra penale nga ana e Policisë e cila vepron në qytetin e Tetovës dhe rrajon.¹⁰³

		2013	2014	2015	2016	2017	2018
Larja e Parave	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0
Trafikim me substanca narkotike	Vepra	20	76	29	31	25	90
	Kryerës	29	129	35	40	25	100
Vjedhje	Vepra	703	652	447	478	366	418
	Kryerës	185	308	282	330	185	265
Vrasje	Vepra	2	1	5	1	2	2
	Kryerës	1	1	9	2	1	13
Trafikim me njerëz	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0
Trafikim me të mitur	Vepra	0	0	0	0	0	0
	Kryerës	0	0	0	0	0	0

Në tabelë vërejmë se në Tetovë dhe rethinë nga viti 2013 deri në vitin 2018 nuk është paraqitur asnjë veprë penale larje parash, nga viti 2013 deri në vitin 2018 policia ka zbuluar gjithësej 271 vepra penale të trafikimit me substanca narkotike dhe ka arrestuar 358 pjesmarës, ka zbuluar 13 vrasje dhe ka kapur 27 persona të dyshuar për pjesmarje në këto vrasje, kurse nuk është zbuluar nga policia asnjë veprë penale për trafikim me njerëz dhe trafikim me të mitur.

¹⁰² Elmedin Muratbegović, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë 2006, fq.34.

¹⁰³ Të dhëna të siguruara nga Stacioni Policorë i Tetovës më datë 29.07.2019

4.2. Roli i Prokurorisë në parandalimin e kriminalitetit në Komunën e Tetovës

Prokuroria është organ shtetërorë e cila së bashku me gjykatën përbëjnë themelin e sistemit gjyqësorë të çdo shteti dhe emërohet me ligj për luftimin e kriminalitetit sepse përveç rolit të mbrojtjes së ligjit dhe të kushtetutës kjo është përgjegjëse edhe për ndjekjen penale të çdo personi fizik dhe juridik të dyshuar për veprë penale.¹⁰⁴

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut prouroria publike është organ shtetërorë i pavarur i cili përpos që ndjek kryesisht e veprave penale dhe veprave të tjera ndëshkuese, kryen edhe punë tjera të parashikuara me ligj. Prokuroria publike i kryen funksionet e veta në bazë të nenit 106 të Kushtetutës së R.M.V dhe ligjit .¹⁰⁵

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit publik janë përcaktuar nenin 39 të Ligjit për procedur penale siç varijon: Në çështjet penale për të cilat ndjekja penale është zyrtare, prokurori publik ka të drejtë dhe detyrë: 1) të drejtojë veprimet e autoriteteve përgjegjëse për zbulimin dhe raportimin e krimeve dhe autorëve të tyre, 2) të propozojë ose lëshojë një urdhër për ndërmarrjen e masave të posaçme hetimore, në kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, 3) të nxjerr urdhra dhe zhvilloj procedura hetimore, 4) të gjejë, propozojë dhe sigurojë prova, në kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj. 5) të propozoj masa të përkohshme për të siguruar pronën ose sendet e marra nga krimi ose të aprovoj masën e konfiskimit, 6) të vendos për shtyrjen e ndjekjes penale në kushte dhe mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, 7) të propozoj lëshimin e urdhrit të ndëshkimit në kushte e përcaktuara me këtë ligj, 8) të negociojë për pranimin e fajit, në mënyrë dhe në kushte e përcaktuara me këtë ligj, 9) të paraqesë dhe akuza përpara gjykatës kompetente, 10) të parashtrojë ankesa kundër vendimeve gjyqësore të pavlefshme (që nuk kanë formën e prerë dhe paraqet mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, 11) vendos për ankimin e palës së dëmtuar në rastet e përcaktuara me këtë ligj; dhe 12) ndërmerr veprime të tjera të përcaktuara me ligj.¹⁰⁶

Përveç ndjekjes së veprave penale larje parash, prodhim i palejuar dhe trafikim i lëndëve të ndryshme narkotike, trafikim me njerëz dhe të mitur, vjedhje, vrasje e tjera, prokuroria me të njejtin ligj ka kompetencë të veproj edhe për vepra penale si keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe

¹⁰⁴ Muhamed Budimlić, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë 2006, fq.75

¹⁰⁵ Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq.91.

¹⁰⁶ http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Zakon_za_Krivicna_postapka_150_18112010-2.pdf:parë më 21.10.2019.

kompetencave, pranim i ryshfetit me vlerë të madhe, për ndërmjetime joligjore të kryera nga funksionarë të zgjedhur apo emëruar.¹⁰⁷

Gjatë procesit hetues prokurori publik mund të ndërmarrë edhe këto veprime hetuese: kontrollin apo bastisjen, sigurimin e përkohshëm të pronës dhe marjen e sendeve, të mer në pyetje të dyshuarit, të mar në pyetje dëshmitarët, të caktoj ekspertimin etj. Në këtë policia luan rol të rëndësishëm në ofrimin e mterijalit të nevojshëm për fillimin e procedurës penale. Policia me urdhër të prokurorit publik ndërmer një sërë masash dhe aktiviteteve me qëllim të zbulimit, hetimit, parandalimit të pasojave të mëtutjeshme të veprave penale, kapjes dhe denoncimit të kryesve të tyre, sigurimit të provave, masave dhe aktiviteteve tjera të cilat do të mundësojnë pa pengesa realizimin e procedurës penale. Poashtu prokurori publik mund ti pushoj hetimet kur nuk ka prova se i dyshuari ka kryer vepër penale, kur vepra penale është përfshi në amnesti ose falje, dhe kur vepra për të cilin ngarkohet i pandehuri nuk është vepër penale.¹⁰⁸

Raporti i veprave penale në Prokurorinë Themelore në Tetovë.¹⁰⁹

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Larja e Parave	0	0	0	1	0	1
Trafikim me substanca narkotike	20	66	29	37	25	82
Trafikim me njerëz	4	0	1	0	0	0
Trafikim me të mitur	0	0	0	0	0	0
Vrasje	2	1	5	1	2	2
Vjedhje	141	116	58	55	36	34

Vështruar në tabelën e më sipërme vërejmë se në Prokurorinë Themelore të Tetovës që nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë paraqitur dhe hetuar dy vepra penale të larjes së parave, figurojnë gjithësej 259 raste të trafikimit me substanca të ndryshme narkotike koncretishtë në vitin 2013 janë paraqitur 20 raste ku janë hetur 19 vepra kurse për një vepër është pushuar hetimi, në 2014 gjithësej ka pasur 66 raste ku për 5 prej tyre është pushuar hetimi, në 2015 gjithësej 29 raste dhe të gjithë kanë poceduar në gjykatë, në 2016 numri total figuron në 37 që për 4 vepra është pushuar hetimi, në 2015 numri total i rasteve figuron 25 dhe të gjitha kanë

¹⁰⁷ Dr.Nexhat Elezi, Sistemi i Gjyqësisë dhe Prokurorisë në Republikën e Maqedonisë, Shkup 2016, fq.147

¹⁰⁸ Ismail Zejneli & Ejup Sahiti, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 94-95,227.

¹⁰⁹ Të dhëna të siguruara nga Prokuroria Themelore e Tetovës më datë 16.10.2019

proceduar në gjykatë kurse në vitin 2018 janë evidentuar 82 raste në total dhe hetimi është pushuar vetëm për 2 raste. Për veprat penale trafikim me njerëz dhe të mitur, në statistikat e prokurorisë gjatë periudhës kohore gjashtë vjeçare evidentohen vetëm 4 raste të trafikimit me njerëz në vitin 2013 dhe vetëm një rast në vitin 2015, kurse nuk evidentohet asnjë rast i trafikimit me të mitur. Në total nga prokuroria janë paraqitur dhe hetuar 14 vepra penale të vrasjes, saktësishtë evidentohen 2 vrasje në vitin 2013, 1 vrasje në vitin 2014, 5 vrasje në 2015, në 2016 vetëm 1 rast, 2 vrasje në 2017 dhe 3 vrasje në 2018. Kur jemi te veprat penale kundër pasurisë, vërejmë një numër me influent krahasuar me evidencat statistikore të veprave të tjera penale që kemi marrë në studim. Në Prokurorinë Themelore të Tetovës nga viti 2013 deri në vitin 2018 në total janë paraqitur 440 vepra penale të vjedhjes, saktësishtë në 2013 gjithësej janë evidentuar 141 vjedhje ku për 35 prej tyre është pushuar hetimi dhe 2 janë ndjekur me padi private, në vitin 2014 totali i vjedhjeve është 116 ku për 19 raste është pushuar hetimi dhe 1 rast është ndjekur me padi private, 58 vjedhje evidentohen në 2015 për 11 është pushuar hetimi kurse 47 kanë proceduar në gjykatë, në 2016 nga 55 vjedhje 1 është ndjekur me padi private kurse për 10 është pushuar hetimi, për 13 raste hetimi është pushuar në 2017, 2 janë ndjekur me padi private dhe 21 janë dorzuar për procedurë penale, kurse në vitin 2018 në statistikat e prokurorisë figurojnë 36 vjedhje që për 13 prej tyre prokurori i ka pushuar hetimet, 2 kanë proceduar me padi private dhe për 21 është poceduar me procedurë penale.

4.3. Roli i Gjykatës Themelore të Tetovës në parandalimin e kriminalitetit

Gjykata është subjekt themelorë i procedurës penale e cila është organ i pavarur dhe funksionin e saj e ushtron duke u bazuar në ligj dhe Kushtetutë dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut pushtetin gjyqësorë e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative dhe Gjykata Supreme. Kompetencat e gjykatave ndahen për nga lloji dhe rëndësia e vepres penale, vendi në të cilin gjykata e ushtron funksionin e gjykimit, cilësia e kryesit të veprave penale dhe lloji i veprimeve proceduralo penale. Gjykata Themelore e Tetovës si gjykatë e shakllës së parë ka kompetencë lëndore të zgjeruar dhe vendos për: veprat penale për të cilat me ligj është paraparë dënim me burg deri në 5 vjet e më shumë, për vepra penale të kryera nga personat e mitur, të vendosin për ankesat dhe kundërshtimet në procedurat për të cilat janë

kompetente, të vendosin për procedurat për ndihmë juridike ndërkombëtare të përcaktuara me ligj, të veprojnë në çështjet e ekstradimit etj.¹¹⁰

Krimi i organizuar është një nga kërcënimet kryesore për sigurinë publike dhe paraqet një pengesë për zhvillimin shoqëror, politik dhe ekonomik të shoqërive në të gjithë botën, poashtu është një dukuri shumëplanëshe që manifestohet përmes llojeve të ndryshme të krimit, siç janë trafikimi i drogës, trafikimi i personave, kontrabanda e migrantëve, trafikimi i armëve dhe pastrimi i parave, ndër të tjera sistemi i drejtësisë penale luan një rol kritik për të identifikuar, akuzuar dhe dënuar atë përmes një procesi sistematik të bazuar në prova.¹¹¹

Në vazhdim nëpërmjet tabelës së mëposhtme do të pasqyrojmë numrin total të lëndëve që janë paraqitur nga viti 2013 deri në vitin 2018 në Gjykatën Themelore të Tetovës, konkretisht do të paraqesim numrin e përgjithshëm të veprave penale të dënuara për larje të parave, trafikim me njerëz, trafikim me të miturve, trafikim me substanca të ndryshme narkotike dhe veprave penale kundër pasurisë.¹¹²

Evidencat statistikore mbi kriminalitetin të cilat i mbajnë gjykatat janë më të preferuara për përcjlljen e të dhënave mbi kriminalitetin në një vend. Këto evidencat kanë të bëjnë me të dhënat mbi aktgjykimet e plotfuqishme të gjykatave për rastet e veprave penale dhe personave të gjykuar për vepra të tilla, që në literaturën kriminologjike konsiderohen se janë më të sakta dhe më të sigurtat të cilat meren edhe si bazë për hulumtimet dhe kërkimet kriminologjike të një vendi.¹¹³

¹¹⁰ Ismail Zejneli & Ejup Sahiti, *Edrejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë*, Shkup 2007, fq.68,80.

¹¹¹ <https://www.unodc.org/lpo-brazil/en/crime/index.html> parë më 08.10.2019

¹¹² Të dhëna statistikore të siguruar nga Gjykata Themelore e Tetovës më datë 18.10.2019

¹¹³ Ragip Halili, *Kriminologjia*, Prishtinë 2007, fq.53-54.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Larja e Parave	0	0	0	1	0	1
Trafikim me substanca narkotike	20	66	29	37	25	82
Trafikim me njerëz	4	0	1	0	0	0
Trafikim me të mitur	0	0	0	0	0	0
Vrasje	2	1	5	1	2	2
Vjedhje	104	96	47	44	21	23

Sa i përket dënimeve të veprave penale që kemi paraqitur në tabelë për periudhën kohore 2013-2018 Gjykata Themelore e Tetovës ka shqiptuar dënim me burg për 2 vepra penale të larjes së parave që janë kryer në vitin 2016 dhe 2018, ka shqiptuar dënime me burg për 13 vrasje që dy prej tyre 2 janë kryer në vitin 2013, 1 në vitin 2014, 5 në vitin 2015, 1 në vitin 2016, 2 në 2017 dhe 2 në vitin 2018, për veprën penale trafikim me njerëz ka dënuar gjithësej 5 raste që 4 janë kryer në vitin 2013 dhe 1 në 2015, janë shqiptuar në total 247 dënime me burg për trafikim të substancave të ndryshme narkotike dhe ka dënuar 335 vepra penale kundër pasurisë.

Përfundimi

Kriminaliteti si dukuri masive dhe si reaksion i individit dhe shoqërisë paraqet epidemi sociale të shfrenuar që godet shoqërinë në të gjitha sferat e civilizimit i cili dita ditës dukshëm po agravon në përmasa seriozishtë shqetësuese që ne sot si komunitet padrejtësishtë jetojmë një situatë të zgjeruar të krimit ku faktorët, vëllimi, dinamika dhe struktura e krimit mbeten të pa definuara tërësishtë. Mirëpo ajo forcë që ka kompetencë dhe pushtet për ta parandaluar dhe luftuar krimin është policia e cila funksionin dhe veprimtarinë e sajë gjithmonë e bazon në ligj, etikë nëpërmjet të cilës punonjësit e policisë kultivohen me vetëdije për ti kuptuar drejtë vlerat morale, për ti respektuar ato me maturi, paanshmëri, përgjegjshmëri, neutralitet, mirësjellje si dhe në parime të cilat janë baza e efikasitetit. Përveç policisë si forcë që ligji e mvesh me fuqi për të zbuluar, luftuar, parandaluar krimin dhe korupsionin po ashtu edhe prokuroria bashkë me gjykatën janë institucione të centralizuara me rëndësi jetike për hetimin dhe denimin e veprave penale.

Është fakt se në vendin tonë kriminaliteti varion me pasoja të mëdha ekonomike, sociale, politike, dhe kërkon një strategji specifike dhe ndër-institucionale mirë të organizuar nga politika dhe pushteti për një luftim sa më efektiv të kësaj dukurie, mirëpo ato që efektivitetin e kahëzojnë kah defektiviteti janë prapaskenat e kriminalitetit që fshehin “SHIFRA TË ERRËTA” dhe “KRIMINEL TË JAKAVE TË BARDHA” me qëndrime despotike. E gjithë kjo konkludohet nëpërmjet hulumtimit që kemi bërë mbi numrin e raportuar, hetuar dhe dënuar të veprave penale për perudhën kohore gjashtë vjeçare, i cili numër nuk raportohet i saktë dhe vërtetonë se Maqedonia dukshëm është e kërcënuar nga krime të natyrave me karakter të rëndë si larje parash, evazion fiskal, trafikim me substanca psikotrope dhe narkotike, trafikim me njerëz, vrapje, vjedhje, grabitje e tjera. Mirëpo ajo që i jep fuqinë si shtet Maqedonisë është se nuk posedon mungesë të kornizës ligjore për ta luftuar, penguar, parandaluar dhe për ta dënuar këto vepra penale, por e gjithë problematika qëndron në mos zbatimin e kësaj kornize ligjore fillimisht nga vetë elita e institucioneve shtetërore e më pas nga grupe të caktuar njerëzish që pretendojnë të zgjohen të pasur.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktualishtë egzistojnë një numër i madhë i institucioneve të cilat merren me parandalimin e kriminalitetit në vend si Policia, Prokuroria, Gjykata, Departamente të veçanta për zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit, Shoqata të ndryshme për parandalim, Njësi speciale me kompetenca të veçanta për luftimin e krimit të organizuar etj. Natyrishtë që Maqedonia si një vend që është në tranzicion dhe si një vend që

shpesh përballet me kriza politike të brendëshme ende nuk ka arritur që të krijoj kushte dhe mekanizma të mjaftueshme për luftimin e korrupsionit dhe kriminalitetit në përgjithësi.

Mos arritja e efikasitetit në luftës kundër kriminalitetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut shpjegohet me Mungesën e përvojës së institucioneve shtetërore, mosgadishmërinë e opinionit publik për paralajmërimin dhe denoncimin e krimit në organet kompetente, me mos hezitimin e shoqërisë për tu bërë pjesë e krimit, me zbatimin e drejtësisë selketive, me mungesën e shërbyesve civil, policisë, prokurorëve, gjyqtarëve etj.

Literatura

- Arjan Dyrmishi, Manual Trajtimi për Integritetin e Policisë, Tiranë 2016.
- Arjan Dyrmishi, Manuali i Etikës dhe Integritetit Policorë, Tiranë 2016.
- Aurela Anastasi, Historia e Institucioneve, Tiranë 1998.
- Criminal Man, Cesare Lombroso, Durham and London 2006.
- David Gadd and Tony Jefferson, Psychosocial Criminology 2007.
- E. Alketa, Droga një sfidë intelegjence, aspektet penalo-juridike dhe krahasuse të saj, Tiranë 2012.
- Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017.
- Elmedin Muratbegović, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë 2006.
- Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997.
- ESB-Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave, Udhëzues mbrojtje të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, Shkup 2017.
- Fatos Haziri, E Drejta e Policisë, Prishtinë 2010.
- Fitim Shishani, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, Prishtinë 2006.
- Goce Xhukleski, Muhamet Racaj, Hyrje në kriminalistikë, Shkup 2012.
- Grup Autorësh, Trafikimi me Njerëz -Aspektet Juridike, Mars 2007.
- Grup Autorësh, Trafikimi me njerëz, Aspektet Juridike, Mars 2007.
- Halili R., Kriminologjia, Prishtinë 2007.
- Haris Halilović & E. Muratbegović, E Drejta Policore, Sarajevë/Prishtinë 2007.
- Haris Halilović, Politika e luftimit të kriminalitetit, Sarajevë 2006.
- Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë, 2009.
- Ismail Zejneli, E DREJTA PENALE-Pjesa e posaçme, Tetovë 2007.
- Korrupsioni, Luan Gjonca, Tiranë 2004.
- Marko Hajdinjak, Smuggling in SouthEast Europe, The Yugoslav Wars and the Development of Regional Criminal Networks in the Balkans, Center for the study of democracy 2002.

- Menada Petro, Lojrat e Fatit, Tiranë 2016.
- Mirsad Suçeska, BAZAT E KRIMINALITETIT EKONOMIK, Prishtinë 2006.
- Muhamed Budimlić, Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë 2006.
- Nedžad Korajlic, Metodika Kriminalistike (deliktete e gjakut, seksuale, pasurore), Sarajevë/Prishtinë 2007.
- Nexhat Elezi, Sistemi i Gjyqësisë dhe Prokurorisë në Republikën e Maqedonisë, Shkup 2016.
- Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE).
- Parandalimi i Kriminalitetit, Elmedin Muratbegović, Sarajevë/Prishtinë, Prill 2007.
- Qebir Avziu, Hyrje në Kriminalistikë, Tetovë 2015.
- R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011.
- Ragip H., Viktimologjia, Prishtinë 2007.
- Ramo M., Policia dhe Shoqëria, Sarajevë 2008.
- Tamara Brnetić, Money laundering best practices, lessons to be learnt and steps to be taken in the balkan region. By a thesis presented in partial completion of the requirements of “The certificate of Training in United Nation Peace Support Operations”.
- Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005.
- Vesel Latifi, Kriminalisika, Prishtinë 2011.

Burime interneti

- <https://www.unodc.org/lpo-brazil/en/crime/index.html>.
- <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>.
- http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Zakon_za_Krivicna_postapka_150_18112010-2.pdf.
- <http://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf>.
- <https://www.unodc.org/documents/southeasterneurope/Guidelines-Macedonian.pdf>.
- https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf.
- <https://www.sobranie.m/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>.
- <http://time.ikub.al/17-12-01-Zbulohet-droge-nga-laboratori-drogave-sintetike-ne-Tetove-FOTO-668505/Detaje-per-laboratorin-me-te-madh-ne-Balkan-per-droge-sintetike.aspx>.
- http://www.kosovopolice.com/repository/docs/kodi_ietikes.pdf.
- <http://centrum.mk/?p=46>.
- <https://mk.wikipedia.org/>.
- [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%2014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%2014_10_2015-1.pdf).
- http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/02/Policija-Merit-Sistem_Studija_Vanchoski_EPI_MK.pdf?fbclid=IwAR1V3IoFLkdAapyjUjUrL8xqM1mrmBwKzZ_jsMgS5NR2R7TWW9kaXNxxx4c.
- <https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Kodeks%20na%20policiska%20etika%2072-07.pdf>.
- <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12305.pdf>.
- <https://shtetiweb.org/2012/09/21/policia-e-shtetit/>.
- <https://www.osce.org/sq/secretariat/23807?download=true>.
- <http://juridiksi.e-monsite.com/blog/analiza-dhe-opinione/familja-faktor-me-rendesi-ne-aftesimin-e-personalitetit-kunder-kriminalitetit.html>.
- <http://telegrafi.com>.

- <http://telegraf.al/i-pakategorizuar/dr-naim-mecalla-krimi-i-organizuar-dhe-pastrimi-i-parave/>.
- <https://balkanweb.com/kerkohet-paraburgim-per-prokuroren-speciale-te-maqedonise-veriore/>.
- http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/pastrimi-i-parava-te-pista.html?fbclid=IwAR3B8hqIkmvYoYk9n6djAeg4svFz04i5yd_c5MGgzvpUImt0ZPUDFRPpQ7k.
- Sluzhben vesnik <http://www.slvesnik.com.mk/>
- “ЗАКОН ЗА ПОЛИЦИЈА,, на Република Македонија.